

# RAPORT VJETOR | 2021

AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)



Adresa: Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd.1, H.6, Tiranë.  
Tel: +355 (0) 42251001, [www.aida.gov.al](http://www.aida.gov.al) | e-mail: [info@aida.gov.al](mailto:info@aida.gov.al)



# RAPORTI VJETOR 2021

**1**

Mesazh i Drejtorit Ekzekutiv të AIDA-s

**2**

Profili i AIDA-s

**3**

AIDA në ushtrim të funksioneve të veta

**4**

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë

**5**

AIDA në aktivitete

**6**

Koordinimi i AIDA-s

**7**

AIDA në përmbushje të transparencës  
dhe rritjes së imazhit ndërinstitucional

**8**

Objektivat për vitin 2022

# 1 MESAZH I DREJTORIT EKZEKUTIV



**Z. Sokol NANO**  
Drejt看 Ekzekutiv

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) konsiderohet si pikë kyçe në nxitjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në vend, si promotore e zhvillimit të mëtejshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe si një entitet i fortë stimulus për produktet 'Made in Albania'.

Viti 2021, për AIDA-n ishte një vit sa i suksesshëm, aq edhe sfidues për shkak të situatës pas pandemisë globale duke ndikuar në mënyrë të pashmangshme në aktivitetet e agjencisë.

AIDA, përgjatë vitit 2021 i ka arritur objektivat duke dhënë kontribut në mbështetjen dhe rimëkëmbjen e biznesit vendas dhe investorëve nëpërmjet informimit të vazhdueshëm, këshillimit, promovimit dhe aksesit në programet dhe skemat mbështetëse të qeverisë, përdorimit të mjeteve dhe platformave ndërvepruese digjitale.

Me besimin se viti 2022, do të jetë një vit edhe më i suksesshëm dhe i frytshëm, AIDA do të vazhdojë t'i përgjigjet nevojave të biznesit vendas për ta bërë atë më konkurrues në tregun vendas dhe në veçanti në tregun e huaj e për t'ju përshtatur edhe më mirë së ardhmes.

AIDA mbetet e angazhuar në shërbimet efektive ndaj investorëve ekzistues, tërheqjen e investimeve të huaja duke promovuar sektorë strategjik e mundësi investimesh, si edhe promovimin e Shqipërisë si një destinacion strategjik.

Me kontributin, dinamikën, profesionalizmin dhe ekspertizën e stafit, sot AIDA është e konfirmuar si struktura administrative kompetente për dhënien e shërbimeve në një "dritare unike" për investorët dhe projektet.

Suksesi i AIDA-s, në përmbushjen e misionit të saj, lidhet ngushtë me konsolidimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me agjencitë homologe, organizatat dhe institucionet lokale e qendrore.

AIDA është mbështetja që ju duhet në vendimin tuaj për të investuar, për të zhvilluar biznesin tuaj dhe për të konkurruar në treg.



## 2 PROFILI I AIDA-S

### 2.1. Misioni

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka për mision të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, të forcojë potencialin eksportues të vendit, të promovojë mbështetjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit. AIDA, maksimizon investimet e brendshme dhe të huaja, nëpërmjet krijimit të iniciativave ndihmuese rrit aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri, përmirëson kapacitetet teknologjike dhe rinovimin e tyre me qëllimet e kombinuara që të rris investimet e huaja direkte, të forcojë kapacitetet e biznesit shqiptar, si edhe të ndërtojë një imazh të denjë të Shqipërisë me fokus tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

### 2.2. Funksionet kryesore të AIDA-s

Veprimtaria e Agjencisë përqëndrohet, kryesisht, në:

- lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë;
- rritjen e aftësisë konkurruese dhe inovative të ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- nxitjen dhe ndihmën ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve;
- nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja.

Agjencia ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si edhe duke ndërmjetësuar e duke bashkëpunuar me investitorët e organet shtetërore.

### 2.3. Kuadri ligjor i Agjencisë

AIDA funksionon në bazë të kuadrit ligjor të posaçëm:

- Ligjit nr. 10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”,
- Statutit të AIDA-s, miratuar me Vendim të Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 2, datë 04.01.2011, të ndryshuar me vendimin nr. 1, datë 25.03.2019,
- Rregullores së Brendshme të AIDA-s, miratuar me vendimin e Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 11, datë 21.07.2011;
- Vendimit nr. 3, datë 17.06.2019 “Për miratimin e nivelit të pagave dhe të strukturës e organikës së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

**Aktualisht, AIDA strukturohet në pesë drejtori:**

1. Drejtoria e Investimeve


2. Drejtoria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Projekteve

3. Drejtoria e Marketing & Kërkim Analizë

4. Drejtoria e Koordinimit

5. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

## 2.4. Organigrama



### Drejtoria e Investimeve ka këto funksione:

- a) Asiston dhe mbështet investimet e drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime;
- b) Ofron shërbimin e përkujdesjes dhe mbështetjes së investitorëve ekzistues ose potencialë;
- c) Asiston dhe mbështet me procedura të përshpejtuara investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë.

### Drejtoria e NVM dhe Projekte ka këto funksione:

- a) Të rrisë aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare për zhvillimin e tyre;
- b) Të jetë në shërbim të sipërmarrësve shqiptarë dhe partnerëve të huaj që dëshirojnë të hyjnë në partneritet me kompani shqiptare nëpërmjet shërbimeve kryesore siç është dhënia e granteve të shtetit shqiptar apo identifikimi i tregjeve ose partnerëve të rinj për eksport, nevojat për trajnim dhe për certifikim produkti, lehtësimin e pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare etj, mbështetje nëpërmjet projekteve të ndryshme me donatorë.

### Drejtoria Marketing & Kërkim Analizë ka këto funksione:

- a) Sigurimin e komunikimit dhe marketingut të institucionit për politikat, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj.;
- b) Kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik.

### Drejtoria e Koordinimit ka këto funksione:

- a) Mbajtjen dhe koordinimin e marrëdhënieve institucionale me institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me departamentet brenda AIDA-s;
- b) Matjen dhe vlerësimin e rezultateve të performancës së institucionit me qëllim orientimin e politikave dhe burimeve.

### Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka këto funksione:

- a) Të mbështesë veprimtarinë e Agjencisë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë zhvillimin e veprimtarisë normale të proceseve të punës;
- b) Të ndjekë të gjithë aktivitetin ekonomik - financiar dhe administrativ të institucionit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## 3 AIDA NË USHTRIM TË FUNKSIONEVE TË VETA

### 3.1. Hyrje

AIDA, ju ndihmon të investoni në Shqipëri duke ju mbështetur me:

**Informacione** mbi mundësitë e investimit në Shqipëri dhe arsyet kryesore përse vendi ynë është tërheqës për Investimet e Huaja Direkte. Të gjithë informacionin rreth ekonomisë së Shqipërisë, burimet njerëzore, infrastrukturës, stimujve investues prezantohen në një shkallë të gjerë me dokumente në shqip dhe anglisht.

**Kontakte** nga Shqipëria apo jashtë saj, falë një pune paraprake anketimi dhe misionëve specifikë të kontaktit për të përmbushur nevojat e investorëve. Qasja jonë është të paraqesim ofertën më të kënaqshme shqiptare për kompanitë që kërkojnë ndërkombëtarizim.

**Këshilla** për mjedisin e përshtatshëm për suksesin e projekteve, rajoneve të funksionimit, planeve të investimeve dhe metodave të financimit.

**Ndihmë** për investorët me vizitat eksploruese në Shqipëri dhe në fazat e ndryshme të zbatimit të projektit. Programet e kontaktit me institucionet dhe kompanitë shqiptare në fushat e aktiviteteve të dëshiruara dhe interesave të investorëve, të cilat përgatiten nga stafi i AIDA-s.

**Mbështetje** për të përmirësuar qëndrueshmërinë e kompanisë përmes monitorimit të personalizuar dhe ndihmës së vazhdueshme me departamentet e ndryshme ministrore shqiptare, si dhe me organizatat dhe autoritetet rajonale

### 3.2. Investimet


#### 3.2.1 Investimet e huaja direkte në Shqipëri (IHD)

##### 3.2.1.1 Krahasim i vitit 2020 – 2021 në terma të fluksit dhe stokut të IHD-ve

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë për vitin 2021, indikator i fluksit shënon vlerën 1,031 milionë euro, 10% më lart krahasuar me një vit më parë, ndërsa stoku shënon vlerën 9,538 milionë euro. Krahasuar me vitin 2020, kemi një rritje me 1 057 milionë euro ose 12.5%.

##### 3.2.1.2 Vështrim krahasues i Fluksit dhe Stokut për periudhën 2017 – 2021

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e fluksit të IHD-ve përgjatë periudhës 2017 – 2021. Vërehet një tendencë e qëndrueshme dhe pozitive e vlerës së fluksit përgjatë viteve. Në vitin 2019 fluksi ka shënuar vlerën 1,073 milionë euro, më e larta nga viti 2017.




Burimi: Banka e Shqipërisë

Për vitin 2021, indikator i fluksit shënon vlerën 1,031 milionë euro.

Krahasuar me vitin 2020, kur fluksi shënonte 937 milionë euro, kemi një rritje me 94 milionë euro ose me 10%, e justifikuar kjo edhe nga përmirësimi i situatës post Covid-19 në vend.

Nga grafiku i mëposhtëm vërejmë se stoku i IHD-ve ka patur një trend rritës përgjatë periudhës 2017-2021 edhe përgjatë periudhës së pandemisë. Indikatori i stokut shënon vlerën 9,538 milionë euro për 2021, vlerën më të lartë përgjatë këtyre 5 viteve. Krahasuar me vitin 2020, kur stoku shënonte 8,481 milionë euro, kemi një rritje me 1,057 milionë euro ose 12.5 %.



Burimi: Banka e Shqipërisë

### 3.2.2. Fluksi dhe Stoku i IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2019 dhe 2020

#### 3.2.2.1. Fluksi sipas aktivitetit ekonomik

Lidhur me shpërndarjen e fluksit të investimeve direkte sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2020, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve ishte energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë që përfaqësonte 27.8% të fluksit total.

Sektorë të tjerë ekonomikë me një kontribut të lartë në IHD për këtë vit ishin sektori i industrisë nxjerrëse dhe aktiviteteve financiare dhe të sigurimit me 14.3%, i aktiviteteve të pasurive të paluajtshme me 8.7% dhe i tregtisë me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave me 6.5% ndaj totalit.

Për 2021, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve në terma të fluksit ishte sektori i industrisë nxjerrëse që përfaqësonte rreth 24% të fluksit total.

Sektorë të tjerë të ekonomisë me një kontribut të lartë janë sektori i aktiviteteve të pasurive të paluajtshme me 18.5%; i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit me 14.7%; i industrisë përpunuese me 9.1% dhe ai i tregtisë me shumicë dhe me pakicë;

riparimi i automjeteve dhe motoçikletave me 6% ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për 2021 sipas aktiviteteve ekonomike kryesore:

| AKTIVITETI EKONOMIK                                                         | VLERA E FLUKSIT 2021 (mln EURO) |
|-----------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|
| Industria nxjerrëse                                                         | 247                             |
| Aktivitete të pasurive të paluajtshme                                       | 191                             |
| Aktivitete financiare dhe të sigurimit                                      | 152                             |
| Industria përpunuese                                                        | 94                              |
| Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikletave | 62                              |

Burimi: Banka e Shqipërisë

#### 3.2.2.2. Stoku sipas aktivitetit ekonomik

Aktiviteti kryesor që ka patur peshën më të madhe të stokut të IHD-ve për vitin 2020 ishte energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë që përfaqësonte 30% të stokut total. Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë në IHD janë sektori i industrisë nxjerrëse me 14.2 %, aktiviteteve financiare dhe të sigurimit me 12.8%, i informacionit dhe komunikacionit me 12.7% dhe i aktiviteteve të pasurive të paluajtshme me 6.4% ndaj totalit.

Për 2021, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve në terma të stokut vazhdoi të ishte energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ajër të kondicionuar që përfaqësonte 28.1 % të stokut total.

Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë janë sektori i industrisë nxjerrëse me 14.7%; aktiviteteve financiare dhe të sigurimit me 12.9%; i informacionit dhe komunikacionit me 11.5%; dhe i industrisë përpunuese me 8.7% ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut për 2021 sipas aktiviteteve ekonomike kryesore:

| AKTIVITETI EKONOMIK                                                  | VLERA E STOKUT 2021 (mln EURO) |
|----------------------------------------------------------------------|--------------------------------|
| Energjia elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar | 2,687                          |
| Industria nxjerrëse                                                  | 1,406                          |
| Aktivitetet financiare dhe të sigurimit                              | 1,228                          |
| Informacioni dhe komunikimi                                          | 1,098                          |
| Industria përpunuese                                                 | 830                            |

Burimi: Banka e Shqipërisë

### 3.2.3. Fluksi dhe Stoku i IHD-ve sipas shteteve për vitin 2019 dhe 2020

#### 3.2.3.1. Fluksi sipas shteteve

Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, për vitin 2020 investimet e huaja në vend janë dominuar nga Holanda e cila ka kontribuar me rreth 22% në fluksin total, ndjekur nga Zvicra me 20.3%, Italia me 12.5%, Turqia me 10% dhe Austria me 7.8%.

Për 2021, investimet e huaja në vend janë dominuar nga Holanda e cila ka kontribuar me rreth 23% në fluksin total, e ndjekur nga Italia me 13.7%, Turqia me 8.6%, Franca me 6.7% dhe Austria me 6.4%.

| SHTETI   | VLERA E FLUKSIT 2021 (mln EURO) |
|----------|---------------------------------|
| Hollandë | 237                             |
| Itali    | 142                             |
| Turqi    | 89                              |
| Francë   | 70                              |
| Austri   | 66                              |

Burimi: Banka e Shqipërisë

#### 3.2.3.2. Stoku sipas shteteve

Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, për vitin 2020 investimet e huaja në vend janë kryesuar nga Zvicra me 18.8% ndaj stokut total, e ndjekur nga Holanda me 16.1%, Kanadaja me 12.8%, Italia me 10%, Turqia me 7.1% dhe Austria me 6.8%.

Për vitin 2021, investimet e huaja në vend janë dominuar nga Zvicra e cila ka kontribuar me rreth 18.4 % në stokun total, e ndjekur nga

Hollanda me 16.3%, Kanadaja me 12.6%, Italia me 10.6%, Turqia me 7.5% dhe Bullgaria me 7.1%.

| SHTETI   | VLERA E STOKUT 2021 (mln EURO) |
|----------|--------------------------------|
| Zvicër   | 1,760                          |
| Hollandë | 1,558                          |
| Kanada   | 1,205                          |
| Itali    | 1,013                          |
| Turqi    | 721                            |
| Bullgari | 682                            |

Burimi: Banka e Shqipërisë

### 3.2.4. Tregtia e Jashtme

#### 3.2.4.1. Të dhëna mbi importet

Vlera e importeve për vitin 2021 shënon vlerën e 6,618 milionë euro, me një rritje të konsiderueshme prej 32.3% nga viti paraardhës. Peshën më të madhe në këtë indikator e përbën grupmali 'Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi' me 21.2% ndaj totalit, i ndjekur nga grupmali 'Ushqim, pije, duhan' me 16.2 % si edhe nga 'Produkte kimike dhe plastike' me 14.3%.

I njëjti tregues, për vitin 2020, arrin vlerën e 5,002 milionë euro. Lidhur me përbërjen e strukturës së importeve në 2020, trendi ka qenë i njëjtë. Peshën kryesore e ka pasur grupmali 'Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi' me 22.1 % ndaj totalit. Më pas renditej grupmali 'Ushqim, pije, duhan' me 18.3% dhe 'Produkte kimike dhe plastike' me 15% ndaj totalit.

| GRUPMALLI                            | Janar - Dhjetor 2020 (mln EURO) | Janar - Dhjetor 2021 (mln EURO) |
|--------------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| Ushqim, pije, duhan                  | 917                             | 1075                            |
| Minerale, lëndë djegëse, ener. elek. | 451                             | 869                             |
| Produkte kimike dhe plastike         | 752                             | 948                             |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure       | 104                             | 123                             |
| Prodime druri dhe letre              | 198                             | 239                             |
| Tekstile dhe këpucë                  | 624                             | 751                             |
| Materiale ndërtimi dhe metale        | 647                             | 924                             |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi  | 1106                            | 1406                            |
| Të tjera                             | 203                             | 284                             |
| TOTALI                               | 5 002                           | 6 618                           |

Burimi: Banka e Shqipërisë

### 3.2.4.2. Të dhëna mbi eksportet

Vlera e eksporteve për vitin 2021 shënon vlerën e 3,048 milionë euro, me një rritje të dukshme prej 35.6% nga viti paraardhës. Peshën më të madhe në këtë indikator e përbën grupmali 'Tekstile dhe këpucë' me 30.4% ndaj totalit, i ndjekur nga grupmali 'Materiale ndërtimi dhe metale' dhe 'Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.' me 21.7% dhe 18.7 % respektivisht.

I njëjti tregues, për vitin 2020, arrin vlerën e 2,248 milion euro. Lidhur me përbërjen e strukturës së eksporteve, në 2020 ka qenë i njëjti trend si 2021, pra peshën kryesore e ka pasur grupmali 'Tekstile dhe këpucë' me 37.6% ndaj totalit. Më pas renditej grupmali 'Materiale ndërtimi dhe metale' me 15.4% dhe 'Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike' me 14.7%.


| GRUPMALLI                            | Janar - Dhjetor 2020 (mln EURO) | Janar - Dhjetor 2021 (mln EURO) |
|--------------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| Ushqim, pije, duhan                  | 323                             | 368                             |
| Minerale, lëndë djegëse, ener. elek. | 330                             | 573                             |
| Produkte kimike dhe plastike         | 61                              | 88                              |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure       | 15                              | 18                              |
| Prodhime druri dhe letre             | 71                              | 84                              |
| Tekstile dhe këpucë                  | 846                             | 929                             |
| Materiale ndërtimi dhe metale        | 346                             | 662                             |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi  | 185                             | 239                             |
| Të tjera                             | 71                              | 87                              |
| TOTALI                               | 2 248                           | 3 048                           |

Burimi: Banka e Shqipërisë

### 3.2.5. Tregu i Punës

#### 3.2.5.1. Indikatorë të Tregut të Punës

Forca e punës gjatë periudhës 2017-2019 ka qenë në rritje, ndërsa në 2020 ka paraqitur një rënie të lehtë e ndjerë nga efektet e pandemisë. Shifrat më të fundit për forcën e punës të T3 2021 shfaq një trend pozitiv për forcën e punës, e cila shënon 1428 mijë persona, duke shkuar sërish në nivelet e vitit 2019.



Niveli i punësimit përgjatë periudhës 2017-2019 ka shfaqur gjithashtu rritje. Në vitin 2019 niveli i punësimit arriti në 1266 mijë të punësuar, duke u rritur me 2,9% nga viti para-ardhës. Gjatë 2020, numri i të punësuarve gjithsej u ul me 1,8% krahasuar me 2019. Shifrat e T3 2021 paraqesin një rritje prej 1,9% krahasuar me vitin 2020, duke e sjellë numrin e të punësuarve gjithsej në 1267 mijë.

Niveli i papunësisë ka treguar një ulje prej 2.4 pikë përqindje nga viti 2020 në T3 2021, duke arritur nivelin e 161 mijë të papunëve (për grup-moshën 15-74 vjeç). Në tremujorin e tretë 2021, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 11,3 %. Niveli i papunësisë u ul me 2,4 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2020, dhe është ulur me 0,7 %, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

#### 3.2.5.2. Punësimi sipas aktivitetit ekonomik

Për sa i përket punësimit sipas aktiviteteve ekonomike në vitin 2020, sektori i shërbimeve (shërbime të tregut dhe shërbime jo të tregut) dhe sektori bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 43,4 % dhe 36,1 % të të punësuarve gjithsej.

Viti 2020 ruajti të njëjtat karakteristika të vitit të mëparshëm, i cili njohu një rritje të punësimit në sektorin e shërbimeve të tregut dhe manufakturës, rritje e numrit të të punësuarve me pagë dhe ulje e numrit të të vetëpunësuarve. Tregu shqiptar i punës është ende jo mikpritës i profesioneve të lira, të cilat shpesh shndërrohen në biznese familjare me punëtorë familjarë të pa paguar.



## Punësimi sipas aktivitetit ekonomik (në %)


|                        |      |      |      |
|------------------------|------|------|------|
| Bujqësi                | 37.4 | 36.4 | 36.1 |
| Shërbime të tregut     | 25.7 | 27.2 | 27.2 |
| Shërbime jo të tregut  | 17.2 | 16.3 | 16.2 |
| Prodhim / Mani-fakturë | 10.6 | 10.9 | 11.2 |
| Ndërtim                | 7    | 7    | 7    |
| Industri të tjera      | 2.2  | 2.2  | 2.3  |

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 3.2.5.3. Punësimi sipas statusit në punësim

Në vitin 2020, rezulton se 46,1 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 33,3 % janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 20,6 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

## Punësimi sipas statusit në punësim (në %)



Burimi: INSTAT

**Paga minimale** është nga ata indikatorë të tregut të punës me dy impakte direkte: është indikator që tërheq interesin e investitorëve të huaj, por njëkohësisht përcakton edhe standartin e investimit potencial të huaj.

|               | 2017  | 2018  | 2019  | 2020  | 2021  |
|---------------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Paga Minimale | 24000 | 24000 | 26000 | 26000 | 32000 |

## Paga mesatare

Në vitin 2020, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 53.662 lekë.

Për T3 2021 paga mesatare bruto është 56.435 lekë, duke u rritur me 6,9 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. Paga mesatare bruto paraqet një trend në rritje si për sektorin privat, po ashtu edhe për atë shtetëror.

Për T3 2021 paga mesatare bruto është 56.435 lekë, duke u rritur me 6,9 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. Paga mesatare bruto paraqet një trend në rritje si për sektorin privat, po ashtu edhe për atë shtetëror.

|                                            | 2017  | 2018  | 2019  | 2020  | T3 2021 |
|--------------------------------------------|-------|-------|-------|-------|---------|
| Paga mesatare mujore bruto                 | 48967 | 50589 | 52380 | 53662 | 56435   |
| Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror | 59813 | 61023 | 63084 | 64330 | 64330   |
| Paga mesatare mujore në sektorin privat    | 44027 | 45759 | 47532 | 48620 | 51305   |

Burimi: INSTAT

## 3.2.6. Lead Generation &amp; AfterCare

## 3.2.6.1. Arritje pozitive në politikën e investimeve

Referuar raportit të *OECDSEE Competitiveness Outlook 2021*, mbi perspektivën e konkurrueshmërisë së rajonit të Europës Juglindore, Shqipëria ka përmirësuar performancën e saj në politikën e investimeve dhe promovimit. Vlerësimi i ekonomisë është rritur nga 2.6 në 2018 në 3.1 në 2021.

Shqipëria është ekonomia e tretë me performancën më të mirë në rajonin e Ballkanit Perëndimor për politikat e lehtësimit dhe promovimit të investimeve, duke shënuar mbi mesataren rajonale.

Hyrjet neto të IHD-ve kanë përfaqësuar mesatarisht 8.2% të PBB-së së ekonomisë gjatë pesë viteve të fundit, duke e bërë Shqipërinë një nga performuesit më të mirë të ekonomive të *Western Balkan 6*. Kjo është gjithashtu një performancë më e mirë se mesatarja për vendet me të ardhura të mesme të larta (2.0% të PBB) dhe ekonomitë e *OECD* (2.4% të PBB), gjatë së njëjtës periudhë.

**Gjetjet pozitive të raportit përqëndrohen në pikat si më poshtë:**

- Tregu i Shqipërisë është i hapur dhe përjashimet nga trajtimi kombëtar janë të kufizuara.
- Mbrojtja e investitorëve kundër shpronësimit e garantuar në Kushtetutë dhe në ligj.
- Investitorët e huaj kanë të njëjtat të drejta dhe mjete juridike para sistemit gjyqësor kombëtar si investitorët vendas lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- Shqipëria ka një strukturë solide dhe një agjenci efikase për promovimin e investimeve.
- Shqipëria ka forcuar shërbimet dhe aktivitetet e saj për lehtësimin e investimeve.
- Shqipëria ofron një gamë të gjerë stimuljsh dhe incentivash për investitorët, të gjitha të listuara në faqen e internetit të AIDA -s.

### 3.2.6.3. Gjenerimi i Leads, ndjekja dhe follow up i tyre

Që prej hapave të para të krijimit të biznesit në Shqipëri, AIDA ka ofruar me sukses asistencë ndaj investimeve të rëndësishme të ardhura rishtazi në sektorin automotive, në dy vitet e fundit, kompani të tilla si *Giobert, Delmon, Rework (B-810), Yura Corporation, Sumitomo Group (Sews-Cabind)*, të cilat kanë zgjeruar aktivitetin në terma investimi, si dhe numër punonjësish edhe përgjatë 2020. Për shkak të efekteve të pandemisë dhe pasigurisë që ka krijuar te kompanitë që operojnë me zinxhirë globale vlere, për investime të reja, në AIDA përgjatë vitit 2020 janë shfaqur interesa për prodhimin e materialeve mbrojtëse të shëndetit.

AIDA vazhdimisht asiston kompanitë e interesuara duke u mundësuar informacion të përditësuar mbi klimën e biznesit në Shqipëri, sistemin e taksave, lehtësirat që ofrohen për investitorët e huaj, kuadrin ligjor për investimet, mundësitë për partneritete me biznese vendase, etj.

Përgjatë vitit 2021 u arrit në total numri i 19 projekteve “Lead” në ndjekje nga AIDA. Shtetet e tyre të origjinës janë kryesisht Italia, Gjermania dhe Kina ndjekur nga kompani të tjera me origjinë hollandeze, austriake, hungareze, amerikane dhe sllovaqe, të cilat kanë shprehur interes për realizimin e investimeve në sektorë të ndryshëm në Shqipëri.

Duke mbajtur parasysh që jo të gjitha investimet

potenciale kanë shprehur vlerën e investimit dhe punësimin që do të gjenerojnë, konstatojmë se vlera totale e këtyre investimeve arrin përafërsisht vlerën prej 132 milionë euro, ndërsa parashikohet që numri i të punësuarve në këto aktivitete të jetë mbi 8380.

Për sa u përket fushave të aktivitetit të këtyre projekteve, interesi kryesor dhe më i madh ka qenë në sektorët e industrisë automotive, industrisë përpunuese dhe manifakturës, ndjekur nga sektorë të tjerë si: energjia e rinovueshme, bujqësia, ndërtimi në zona ekonomike dhe BPO.

Në fund të vitit 2021 rezulton që nga të gjitha projektet “Lead”, 15 prej tyre vazhdojnë ende të ngelen aktive dhe do të ndiqen në hapat e mëtejshëm nga AIDA.

### 3.2.6.4. Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (BIDS), është një dokument ligjor me rëndësi të veçantë për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo strategji përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afat-mesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si edhe investimet.

AIDA është një aktor i rëndësishëm në implementimin në praktikë të BIDS dhe praktikave të parashikuara nga strategjia. Në tërësinë e saj “BIDS 2021 – 2027”, përbëhet nga një qëllim strategjik kryesor që është “Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integritit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës”. Në këtë qëllim strategjik zënë vend po ashtu edhe objektiva specifike që reflektojnë nevojën për ndryshim apo shtimin e dimensioneve të reja drejt të cilave duhet të fokusohet vëmendja për adresimin e duhur të çështjeve të zhvillimit të biznesit dhe investimeve të huaja, bazuar dhe në zhvillimet më të fundit, si dhe duke konsideruar çështje të lidhura me pandeminë e COVID-19 apo fushat e reja deri tani të paadresuara apo shumë pak të adresuara në



lidhje me biznesin (ndryshimet teknologjike, digjitalizimi, etj).

Në përmbushje të vizionit të BIDS 2021-2027 institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë, në partneritet me institucione dhe organizata të tjera, do të fokusohen në tërheqjen e investimeve dhe ndërkombëtarizimin përmes masave përkatëse.

### 3.2.6.7. Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi

Strategjia e re vendos theksin mbi rëndësinë strategjike të investimeve dhe integritit në zinxhirin e vlerave dhe tregjet ndërkombëtare për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm si dhe shpalosjen e plotë të potencialit investues për zhvillim ekonomik.

#### Masat:

1. Promovimi /lehtësimi sistematik i investimeve të synuara;
2. Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme;
3. Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve.

### 3.2.6.8 Aftercare

Gjatë vitit 2021, Sektori *AfterCare* iu rikthye aktivitetit normal pas periudhës njëvjeçare të pandemisë, e cila kushtëzoi veprimtarinë e sektorit pa takime pranë bizneseve, por përmes ndërlidhjes nëpërmjet pyetësorëve apo asistencës në distancë. Plani i veprimit i parashikuar për vitin 2020 u zhvendos në 2021, me dy bashki të reja: Kavajë dhe Vorë.

Në vitin që lamë pas janë zhvilluar 12 takime pranë kompanive. Gjithashtu janë finalizuar me sukses 12 aktivitete asistence, ndërsa 8 çështje vijnë të jenë në ndjekje. Edhe gjatë këtij viti AIDA i ka asistuar kompanitë hap pas hapi për çdo problematikë, duke ndërmjetësuar me njësitë e qeverisjes vendore dhe ato qendrore, duke vendosur kështu një kanal efektiv komunikimi mes palëve, por dhe duke mundësuar bashkëpunimin mes tyre.

### 3.2.6.9 Plani i Veprimit *Aftercare* për vitin 2021

Në vazhdim të aktiviteteve dhe takimeve që AIDA zhvillon pranë bizneseve me përfaqësues të bashkive të vendit, gjatë vitit 2021 u targetuan kompani të sektorëve të ndryshëm për vizita në Kavajë dhe Vorë si: turizëm, kompani ndërtimi, shkolla profesionale etj. Një ndër synimet kryesore ishte marrja e një *feedback*-u sa i përket bizneseve që operojnë në sektorin e turizmit, si më i prekuri nga pandemia COVID-19. Gjithashtu synohej dhe vendosja e kontakteve me kompani të reja, që nuk ishin pjesë e databazës së brendshme *aftercare*, në funksion të diversifikimit të sektorëve të kompanive ekzistuese në databazë, por dhe pasurimit të kësaj të fundit me subjekte të rinj, duke u prezantuar kështu dhe aktivitetin institucional të AIDA-s dhe vëmendjen e veçantë që ka ndaj investitorëve të huaj apo vendas, që tashmë operojnë në Shqipëri.

Kompanitë që u përzgjodhën për t'u vizituar në Bashkitë Vorë dhe Kavajë ishin në sektorë të ndryshëm, kjo me qëllim diversifikimin e industrive dhe garantimin e asistencës të sa më shumë kompanive. Sektorët në të cilët operonin kompanitë varonin nga: industria e fasonerisë, turizëm, bujqësi, agrobiznes, si dhe kompani në fushën e ndërtimit.

AIDA është e përkushtuar ndaj garantimit të shërbimeve të asistencës për kompanitë e vendosura në Shqipëri dhe në këtë kuadër i merr në konsideratë të gjitha shqetësimet e shfaqura nga subjektet. Një prej kompanive të asistuar ishte dhe kompania *Saint Gobain*, një kompani ndërkombëtare e cila operon në fushën e ndërtimit. Kompania kishte disa problematika si: sistemimi/pastrimi i kanalit kullues pranë vendndodhjes së subjektit i cili u shkaktonte dëme të konsiderueshme si rezultat i përmblytjeve të vazhdueshme, si dhe vendosja e koshave të mbeturinave joindustriale pranë subjektit.

Për këto problematika AIDA mundësoi lidhjen me përfaqësues të bashkisë Vorë, të cilët u vendosën në komunikim për të zgjidhur çështjet si më sipër. Një problematikë tjetër e shfaqur nga subjekti lidhej me adresimin pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi çështjen e përmendjes

së emrave të brand-eve në manualin e ndërtimit, si dhe vendosjen e kriterëve përcaktues/përrjashtues të cilët nuk ishin përditësuar prej kohësh. AIDA e ndoqi me prioritet këtë problematikë, duke zhvilluar dhe takime pranë Autoritetit të Konkurrencës duke adresuar problematikat e kompanisë. AIDA gjithashtu dërgoi shkresë pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si institucioni përgjegjës i cili ka tagrin për të iniciuar ndryshime në Manualin e Ndërtimit.

Asistenca e AIDA përfshiu jo vetëm bizneset, por dhe shkollat profesionale.

AIDA gjatë këtij viti, përfshiu në programin e shërbimit të përkujdesjes ndaj investitorit dhe shkollat profesionale, duke qenë këto një hallkë shumë e rëndësishme për punësimin e forcës punëtore që del nga këto shkolla, bazuar në kurrikulat përkatëse. Në këtë kuadër AIDA realizoi dy vizita pranë dy shkollave profesionale në bashkitë e Vorës dhe Kavajës, respektivisht Shkolla e Mesme Profesionale "Charles Telford Erikson" e cila ka programe në pedagogji, agrobiznes, turizëm, ekonomi dhe veterinar, dhe Shkolla e Mesme Profesionale "26 Marsi" e cila ka programe në mekanikë të përgjithshme dhe instalim sistemesh termohidrolike. Shkolla profesionale "26 Marsi", duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me biznesin vendas, ishte hasur me një problematikë, për shkak të mbylljes së degës së teknologjisë së informacionit. Në përfundim të takimit AIDA dërgoi një shkresë në Ministrinë e Financave, duke propozuar ri-hapjen e degës së studimit teknologji informacioni dhe komunikimi në Shkollën e Mesme Profesionale "26 Marsi", kjo për të përshtatur kurrikulat me nevojat e tregut të punës dhe kërkesave të investitorëve.

Pjesa më e madhe e bizneseve të vizituara nuk raportuan problematika të thella sa i përket pandemisë. Secila prej tyre e kishte vijuar aktivitetin normal në ambientet përkatëse, pa patur nevojë për shkurtim të stafit apo masa të tjera të këtij kuadri. Kompanitë e ndërtimit ishin sektori që vijoi normalisht punën edhe gjatë vitit pandemik, duke mos referuar kështu për humbje financiare.

### 3.2.6.10 Programi me qeverisjen lokale dhe bashkëpunimi me IFC/Bankën Botërore dhe GIZ

Që prej gati katër vitesh AIDA ka patur një rol proaktiv ndaj përqasjes së investitorëve të huaj të pranishëm në Shqipëri. Për këtë qëllim pranë këtij institucioni vepron një organ i dedikuar për përkujdesjen ndaj investitorëve të huaj ose shqiptarë, që janë tashmë të vendosur në Shqipëri, duke i asistuar për çdo problematikë që mund të kenë gjatë zhvillimit të planit të tyre të biznesit, duke lehtësuar procedurat me institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore me qëllim krijimin e kushteve për ri-investime.

Në kuadër të një Plani Veprimi të përpiluar për vitin 2018-2019, AIDA është përfshirë në krijimin e një rrjeti efektiv komunikimi e bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm në nivel lokal dhe qëndror në funksion të nxitjes së këtyre ri-investimeve.

Kështu, AIDA ka institucionalizuar bashkëpunimin me qeverisjen lokale, për të qenë në një sinergji të përbashkët kundrejt përmirësimit të shërbimit të investitorëve të huaj të pranishëm dhe gjenerimin e investitorëve të rinj. Me asistencën e IFC/Banka Botërore, AIDA po zhvillon një mekanizëm në zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të investitorëve në Shqipëri.

Faza e parë e nismës ka qenë trajnimi i stafit të dy bashkive pilote (Elbasan dhe Lezhë) mbi shërbimet "Investment Promotion & After-care". Kjo fazë kishte për qëllim testimin e efektshmërisë së mekanizmit.

Gjatë fazës së dytë janë trajnuar stafet e 6 bashkive të përfshira (Shkodër, Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Berat) për ta shtrirë kështu njohjen dhe përvetësimin e konceptit *AfterCare*. Duke vijuar, rrjeti i bashkëpunimit me qeverisjen lokale është zgjeruar me 8 Bashki në gjysmën e parë të vitit pasardhës.

Janë përcaktuar "focal points" në çdo Bashki dhe është trajnuar stafi mbi konceptin *After Care* dhe mënyrën e organizimit të vizitave

pranë bizneseve. Faza e tretë ka qenë përzgjedhja e 2 kompanive për secilën bashki dhe organizimi i vizitave në këto bashki.

Në vazhdimësi të punës së vitit të mëparshëm, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2019 është riaktivizuar rrjeti i bashkëpunimit me 41 takime në bashkëpunim me 8 bashkitë e vendit: Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë, Fier dhe Elbasan. Këto takime kanë konsoliduar raportin mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, duke patur në vëmendje investitorët ekzistues dhe sidomos nxitjen e riinvestimeve. Në fund të 41 takimeve AIDA ka përpiluar një raport të hollësishëm, i cili i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në funksion të një panorame më të qartë mbi klimën e biznesit në Shqipëri dhe përmirësimit të mëtejshëm.

Spektori *AfterCare* është në komunikim të vazhdueshëm me grupet përkatëse të interesit, të rëndësishëm në nivelin lokal dhe qendror, me qëllim promovimin e riinvestimit në Shqipëri. Ky bashkëpunim nuk është ndalur me takimet e mësipërme, por vijon përgjatë punës së përditshme të AIDA-s duke ndjekur hap pas hapi kompanitë që operojnë në vendin tonë dhe duke i ndërlidhur me institucionet shtetërore për një mbarëvajtje sa më eficiente të planit të tyre të biznesit. Efektivisht kjo përkthehet në rritjen e vendeve të punës dhe përmirësimin e përgjithshëm të klimës së investimeve në vend.

Plani i Veprimit vijoi me zbatimin për vitin 2021. AIDA së bashku me GIZ (*ProSEED*), me partner Zyrën e Kryeministrit, si dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ndërmorën një projekt të përbashkët për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit *AfterCare*. Qëllimi i kësaj iniciative ishte thellimi i mëtejshëm i zinxhirit të komunikimit mes AIDA-s, Bashkive, Institucioneve të Edukimit & Kërkimit, si dhe investitorëve prezentë në zonë, duke synuar përmirësimin e bashkëpunimit mes tyre, përkrahjen e investimeve ekzistuese, nxitjen e ri-investimeve dhe promovimin e resurseve lokale.

Faza e parë e projektit përfshiu trajnimin e stafit të 2 Bashkive të reja, Vorë dhe Kavajë. Ekspertët e GIZ së bashku me AIDA-n gjyquan të duhur përzgjedhjen e këtyre bashkive, kjo bazuar në

përqëndrimin e madh të numrit të bizneseve që operojnë në këto bashki. Duke marrë në konsideratë faktin që AIDA nuk kishte marrëveshje bashkëpunimi me këto dy bashki, ishte e rëndësishme vendosja e linjave të komunikimit. Përqëndrimi i madh i bizneseve në këto bashki vjen si rrjedhojë e pozitës së favorshme gjeografike dhe afërsisë që ka me portin e Durrësit, duke qenë se një pjesë e kompanive prezente eksportojnë mallrat/produktet e tyre jashtë vendit. Faktor tjetër i rëndësishëm për këtë përzgjedhje ishte dhe prezenca e forcës punëtore në këto bashki.

Qëllimi i njohjes me konceptin e *AfterCare*, nuk ishte vetëm prezantimi i stafit të bashkive me shërbimin *AfterCare* për investitorët ekzistues, por edhe lehtësimi, ndërmjetësimi i kompanive në çështje që lidhen me aktivitetin e tyre. Kjo ndihmon në mbrojtjen e investimeve ekzistuese dhe zgjerimin e tyre të vazhdueshëm.

Në fazën e dytë, Spektori *AfterCare* dhe përfaqësuesit e bashkive ndërmorën takime në kompani të ndryshme në funksion të zhvillimit të planit të biznesit, punësimit, eksporteve, planet afatshkurtra dhe afatgjata, duke synuar inkurajimin e riinvestimeve. Bazuar në Planin Vjetor të Veprimit të AIDA-s, 5 kompani u përzgjedhën për secilën bashki, për t'u vizituar nga stafi përkatës.

### 3.2.7 Pronat shtetërore dhe zonat me përparësi zhvillimi

Bazuar në legjislacionin sektorial, propozimi për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimi mund të bëhet nga ministritë e linjës, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Komiteti i Investimeve Strategjike.

Identifikimi, shpallja dhe përcaktimi i mënyrës dhe rregullave të funksionimit të zonave, të cilat do të konsiderohen me përparësi zhvillimi, kryhet rast pas rasti, nga Këshilli i Ministrave, me vendim të posaçëm.

Bazuar në VKM nr. 1023/2015, zhvillimi i zonave me përparësi zhvillimi fokusohet, kryesisht, në:

a) orientimin e investimeve në zona të caktuara

territoriale, me qëllim nxitjen e përqendrimit të llojeve të njëjta apo të ngjashme të industrive apo veprimtarive tregtare, në mënyrë që të përfitohet nga specializimi i punëkërkuësve, ekonomitë e shkallës dhe ndarja e kostove infrastrukturore. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë rritjen e efikasitetit të infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim, si edhe do të ndërmerren masa për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet industriale;

b) orientimin e investimeve në zona të caktuara territoriale, në të cilat ka nivele të larta papunësie dhe ku zhvillimi ekonomik është në nivele të pakënaqshme, krahasuar me rajone të tjera të vendit. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë zhvillimin ekonomik, rritjen e mirëqenies së popullatës, rritjen e punësimit dhe formimin profesional, si dhe përmirësimin e infrastrukturave.

Kriteret ndihmëse për identifikimin e zonave me përparësi zhvillimi do të jenë:

- studimi i vendndodhjes, përqendrimit, numrit dhe rëndësisë ekonomike të veprimtarive industriale dhe tregtare ekzistuese, me qëllim krijimin e sinergjive ekonomike ndërmjet tyre;
- analiza e gjendjes së infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim;
- niveli i papunësisë së zonës;
- të ardhurat ekonomike për banor, si edhe kriteret të tjera ndihmëse, sipas nevojave dhe strategjive publike;
- realizimi i objektivave të mbrojtjes efektive mjedisore;
- shfrytëzimi me efektivitet i aftësive e kualifikimeve të veçanta të punëkërkuësve aktivë të zonës;
- statistikën e zhvillimit ekonomik të zonës përkatëse, sipas studimeve të INSTAT-it apo enteteve të tjera publike;

Gjatë vitit 2021, AIDA ka vazhduar të kryejë verifikime përkatëse për prona shtetërore të cilat kanë potencial për t'u konsideruar si zona me përparësi zhvillimi dhe rrjedhimisht si zona potenciale për tërheqjen e investimeve të huaja në vend.

Zonat në fjalë janë zona me potencial për krijimin e një poli ekonomik, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të bashkive përkatëse, ç'ka do të mund të realizohet nëpërmjet investimeve të ndryshme.

Shpallja e një zone me përparësi zhvillimi do të mundësojë rihzhvillimin dhe pasurimin e saj me funksione të ndryshme, duke ndikuar në rritjen ekonomike të zonës. Objektivi kryesor i shpalljes së një zone me përparësi zhvillimi, do të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën dhe larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm.

Më konkretisht, AIDA, gjatë vitit 2020, ka identifikuar zonat:

#### • Ish Kombinati Metalurgjik

|                  |                                            |
|------------------|--------------------------------------------|
| Prona:           | Ish Kombinati Metalurgjik                  |
| Vendndodhja:     | Njësia Administrative Bra-dashesh, Elbasan |
| Zona Kadastrale: | 3965                                       |

#### • Aseti Uzina e Plehrave Azotike

|                 |                                |
|-----------------|--------------------------------|
| Prona           | Aseti Uzina e Plehrave Azotike |
| Vendndodhja     | Njësia Administrative Fier     |
| Zona Kadastrale | 1557                           |

#### • Aseti Fabrika e Duhan-Cigareve

|                 |                                |
|-----------------|--------------------------------|
| Prona           | Aseti Fabrika e Duhan-Cigareve |
| Vendndodhja     | Shkodër                        |
| Zona Kadastrale | 8592                           |

#### • Uzina e telave dhe e kabllave

|                 |                               |
|-----------------|-------------------------------|
| Prona           | Uzina e telave dhe e kabllave |
| Vendndodhja     | Shkodër                       |
| Zona Kadastrale | 8592                          |

- Ish Vaskat e Peshkut**

|                 |                                      |
|-----------------|--------------------------------------|
| Prona           | Ish-Vaskat e Peshkut                 |
| Vendndodhja     | Njësia Administrative Drenovë, Korçë |
| Zona Kadastrale | 1538                                 |

- Prona private**

Përgjatë vitit 2021, AIDA ka qenë gjithashtu e angazhuar në identifikimin e pronave të tjera private, të cilat mund t'ju paraqiten investitorëve potencialë me qëllim shtimin e opsioneve të tyre për të konkretizuar investimin në Shqipëri. Ndër këto prona vlen të përmendet Kamza Industrial Park, një projekt për realizimin e një zonë me ndërtesa sipas nevojës së investitorëve, me fokus në industrinë manufakturë dhe me akses të lehtë në akse kombëtare dhe fuqi punëtore.

Kamza Industrial Park u është propozuar disa subjekteve gjatë vitit, të cilët janë në komunikim të vazhdueshëm me pronarët e pronës.

### 3.2.8 Iniciativa të Drejtorisë së Investimeve përgjatë 2021

#### 3.2.8.1 Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (BIDS)

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (BIDS), është një dokument ligjor me rëndësi të veçantë për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo strategji përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afat-mesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si edhe investimet.

Gjatë vitit 2021, AIDA ka qenë e përfshirë në detajimin e çështjeve të strategjisë të cilat janë të lidhura ngushtësisht me veprimtarinë e AIDA-s. Referuar objektivit të ndërkombëtarizimit të investimeve, fokusi i Agjencisë ka qenë në pjesëmarrjen në panairin ndërkombëtar EXPO Dubai 2020, panair gjatë të cilit subjekte të shumtë kanë shprehur interes për të mësuar më shumë mbi mundësitë për investime në Shqipëri.

Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e strategjisë janë dhe shërbimet e përkujdesjes ndaj investitorëve ekzistues në Shqipëri, të cilat janë detajuar sa më sipër.

#### 3.2.8.2 Paketat informuese mbi ndryshimet e ligjit për të huajt

AIDA angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në përpilimin e disa paketave specifike informuese të cilat vijnë në ndihmë të investitorëve të huaj duke ju ofruar zgjidhje lidhur me çështje apo problematika që ata hasin para ose gjatë realizimit të investimeve të tyre. Në vijim gjendet një listë me këto paketa të cilat përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me ndryshimet apo rritje që dalin në ligj.

- Paketë informuese lidhur me kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë.
- Paketa informuese lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare, procedurat dhe dokumentacioni përkatës.
- Paketa informuese lidhur me punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë dhe llojet e lejeve të punës.

#### 3.2.8.3. Publikimi i Ligjit të ri Nr. 79/2021 "Për të Huajt"

- Ky ligj rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë dhe synon përmirësimin e fushës së të drejtave të të huajve.
- Ligji përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike e private, shqiptare ose të huaja, që në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente dhe parimin e mosdiskriminimit, kryejnë aktivitete në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që kërkojnë të hyjnë, që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë.
- Ai ka si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit legjislativ të migracionit, duke përfshirë më tej legjislacionin për migracionin, me



direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, të evidentuara gjatë procesit *Screening* për kapitulin 24 "Drejtësia, liria dhe siguria".

- Garanton akses në programe dhe shërbime integrimi për të huajt, mundësinë e ofrimit më të mirë të informacionit, procedurave të lehtësuara për t'u pajisur me leje qëndrimi, si dhe forcimin institucional të ofrimit të shërbimeve për migrantët.
- Ka si qëllim përmirësimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike on-line përmes sistemit *e-visa*, duke synuar zgjidhjen e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të tij, lidhur me pamundësinë për të mbuluar shumë vende me misionë diplomatike apo poste konsullore.
- Plotëson një nga mangësitë e legjislacionit të mëparshëm për të huajt, duke integruar pajisjen me leje unike, e cila garanton një procedurë të vetme të aplikimit për të huajt, që kanë për qëllim të punojnë dhe të qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Gjithashtu, synon përmirësimin e dispozitave të lidhura me çështjen e punësimit të shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë, ku përmes këtij ligji lejet e punës shkrihen me lejet e qëndrimit në një leje unike, duke qartësuar afatet kohore dhe procedurat për t'u pajisur me leje unike, si dhe duke reduktuar pengesat e panevojshme për punësimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Nëpërmjet dispozitave të tij përcakton mundësinë për t'u pajisur me leje qëndrimi edhe për kategoritë e të huajve të cilët kanë hasur vështirësi në të shkuarën, si pensionistët e huaj apo personat pa shtetësi.
- Synon pajtueshmërinë e dispozitave të tij me objektivat e shtetit shqiptar për të lehtësuar hyrjen dhe qëndrimin e investitorëve.

#### 3.2.8.4. Integrimi i platformave digjitale në funksion të tërheqjes së investimeve

Me synimin për të përmbushur rolin e saj në promovimin sistematik dhe të targetuar të investimeve në kuadër të Strategjisë BIDS (*Business Investment Development Strategy*), AIDA është angazhuar në gjetjen e mjeteve sa më efektive që do ndihmonin në arritjen e këtij objekti. Përdorimi i platformave digjitale në promovimin e investimeve njihet si një mjet që rrit në mënyrë cilësore suksesin e fushatave të targetuara për përthithjen e investimeve të huaja (*outreach campaigns*). Bazuar në eksperiencën e punës së përditshme të stafit të investimeve në shqyrtimin e raporteve ndërkombëtare dhe bashkëpunimin me institucionet dhe partnerët ndërkombëtare, një platformë e tillë do përmbushte në mënyrë efektive nevojat e AIDA-s në qasjen proaktive ndaj tërheqjes dhe lehtësimit të Investimeve të Huaja në Shqipëri.

Aksesi në një platformë të tillë është gjithashtu i rëndësishëm në vijim të bashkëpunimit që AIDA ka me *Harvard Growth Lab*, të cilët kanë ndërtuar *Industry Targeting Dashboard* (<https://growthlab.app/albania-tool>), një mjet ndihmues në procesin e targetimit. Ky mjet jep mundësinë e përzgjedhjes nga 272 industri dhe jep informacion mbi përputhjen e industrive përkatëse me aftësitë aktuale prodhuese të Shqipërisë, si dhe avantazhet dhe disavantazhet krahasuese. Me integrimin e një platforme digjitale në *Dashboard*, krahas targetimit të industrive, shfaqen gjithashtu kompanitë kryesore me potencial investimi në ato fusha. Aksesi në këto të dhëna është një ndihmesë e madhe në krijimin e listave cilësore në funksion të targetimit.

Për të vlerësuar opsionet më të mira dhe shërbimet më cilësore që ofrohen nga këto platforma digjitale, stafi i AIDA-s ka zhvilluar një kërkim tregu, me synim blerjen e një platforme të tillë. AIDA ka kontaktuar disa nga kompanitë më të rëndësishme në këtë fushë dhe ka marrë oferta konkrete prej tyre. Mbi këto oferta është bërë një analizë e brendshme për përzgjedhjen e platformës më të përshtatshme dhe cilësore për nevojat e agjencisë. Ky gjykim është ndarë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Për këtë arsye është alokuar një zë i vexhantë në buxhetin e agjencisë për vitin pasardhës, në të cilën pritet blerja e një prej këtyre shërbimeve.

### 3.2.8.5. Pjesëmarrja e AIDA në tryeza pune vendimarrëse

#### *Multi-annual Plan for Regional Economic Area (MAP REA) dhe Common Regional Market (CRM)*

Përgjatë vitit 2021 AIDA ka vazhduar të jetë një ndër aktorët e përfshirë në iniciativat e integritit rajonal. Puna e zhvilluar përgjatë viteve 2017-2020 me MAP REA do të vazhdojë të thellohet nëpërmjet Planit të Ri të veprimit CRM përgjatë viteve 2021-2024. Viti 2020 pa përmbylljen me sukses të planit të veprimit të MAP REA.

Për zbatimin e Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) 2021 – 2024, fokusi deri në këtë pikë ka qenë në mbledhjen e të dhënave për skemat e lehtësimit të investimeve dhe nxitjen e investimeve në nivel rajonal.

Për këtë, Shqipëria ka ofruar:

- Të dhëna për skemat e stimulimit të investimeve të vendit në përputhje me modelin e miratuar bashkërisht nga të gjitha ekonomitë pjesëmarrëse të Ballkanit Perëndimor.
- Ka dhënë kontributin dhe dakordësimin e saj për përzgjedhjen e tre sektorëve (automotiv, përpunimi i ushqimit dhe përpunimi i metaleve) që do të zgjidhen për nxitjen e investimeve rajonale, të cilat janë në përputhje me sektorët e propozuar në Shtyllën e Industrisë dhe Inovacionit.

Aktivitete të tjera të kohëve të fundit në të cilat Shqipëria është përfshirë sipas Planit të Veprimit është krijimi i një "Programi Rajonal të Zhvillimit të Furnizuesve (RSDP)", i cili do të lehtësonte lidhjet e furnitorëve vendas dhe ndërkombëtar ndërmjet Ballkanit Perëndimor në sektorët e synuar/zinxhirët e furnizimit.

Nisma është diskutuar dhe pranuar nga ekonomitë anëtare dhe aktualisht janë duke u planifikuar hapa konkretë për zbatimin e iniciativës.

### 3.2.8.6. Ndryshimi i afatit të zbatimit të Ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Në fund të viti 2021, Drejtoria e Investimeve ishte pjesë e ndryshimit të Ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Me anën e këtij ndryshimi u synua zgjatja e afatit të paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit "Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë", në zbatim të këtij ligji, deri më datën 31 dhjetor 2023.

Ndryshimi i ligjit dhe shtyrja e afatit të vlefshmërisë së tij, u bë me qëllim shmangien e krijimit të boshllëqeve ligjore si dhe të pasojave që mund të krijoheshin deri në hartimin e një ligji të unifikuar të investimeve, i cili do të mbrojë njësoj si investimet vendase, por dhe ato të huaja, e me një trajtim si pjesë më vete në të për investimet strategjike, për të cilin është duke punuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ndryshimi ligjor u miratua me ligjin Nr. 130/2021 Për një ndryshim në Ligjin nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, sipas të cilit, tani, në nenin 36 parashikohet se "Afati i fundit për paraqitjen e kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit "Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë", në zbatim të këtij ligji, është data 31 dhjetor 2023".

## 3.3. Investimet Strategjike


### 3.3.1. Hyrje

Me hyrjen në fuqi të paktës së re ligjore për investimet strategjike (datë 24.12.2015), u bë e mundur që investimet vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjikë, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përsheptuara dhe favorizuese.

Në zbatim të kësaj pakete ligjore, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/ investitor strategjik;
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS);
- Agjent asistues i investitorit strategjik.





Referuar legjislacionit të investimeve strategjike, AIDA në cilësinë e One Stop Shop ka të gjithë autoritetin e nevojshëm për të pranuar dosjet, shqyrtuar, kontrolluar përputhshmërinë e aplikimeve dhe më pas të koordinojë vendimmarrjen.

Në këtë aspekt, One Stop Shop:

- kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjik (pra dy statuse të ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planet kombëtare të rregullimit të territorit (proces i cili përfshin një sërë institucionesh njëkohësisht);
- koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda një afati maksimal prej 30 ditësh);
- përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.

Duke qenë se procedurat kanë krijuar tashmë precedent, edhe mbledhjet e KIS për një projekt janë reduktuar. (Ligji 55/2015 parashikon që KIS ka 30 ditë pune afat për të marrë një vendim lidhur me një projekt investimi që i propozohet nga grupi operacional). Njëkohësisht sipas ligjit, KIS, pasi aprovon statusin strategjik, duhet të miratojë dhe planin e veprimit (masat shtetërore) për projektin në shqyrtim. Për këtë arsye, Grupet Operacionale japin kontributin e tyre, njëkohësisht, edhe për vlerësimin teknik të projektit, edhe për planin e veprimit mbi masat shtetërore që vlerësohen se duhet t'i jepen projektit. Mbi këtë bazë, Sekretariati Teknik paraqitet në KIS me dy materiale njëherazi: (i) raport të vlerësimit teknik dhe (ii) plan veprimi. Afati 30 ditor shfrytëzohet për të zbardhur vendimin dhe rekomandime shtesë të KIS.

### 3.3.2. Projektet e vlerësuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë vitit 2020 dhe 2021

Projekte të shqyrtuara nga AIDA 2020-2021

| VITI                             | 2020 | 2021 | TOTALI |
|----------------------------------|------|------|--------|
| Projekte totale                  | 7    | 22   | 29     |
| Projekte të miratuara            | 5    | 17   | 22     |
| Projekte të refuzuara            | 2    | 1    | 3      |
| Shqyrtime të tjera të miratuara* | -    | 4    | 4      |

Përveç sa më sipër, përgjatë vitit 2021 AIDA ka asistuar në fazë paraprake edhe 12 projekte, të cilat, për arsye të ndryshme nuk janë pranuar si aplikime ose subjektet aplikues nuk kanë vijuar me aplikimin përfundimtar, duke e çmuar atë për një moment të dytë.

\* Shqyrtimet e tjera që ka bërë KIS përgjatë vitit 2021 kanë të bëjnë me:

- dhënien e statusit përfundimtar investim/investitor strategjik për 2 projekte;
- shtyrjen e afatit të statusit investim/investitor strategjik për 1 projekt;
- ndryshimin e disa kushteve të statusit investim/investitor strategjik për 1 projekt.

Duhet theksuar se vështirësitë që kaloi vendi për shkak të përhapjes së sëmundjes infektive COVID-19, si dhe masave kufizuese që filluan në vitin 2020, ngadalësuan deri diku ritmin e shqyrtimit të aplikimeve, ose bënë që subjektet investuese të rishikonin planet e tyre të investimit, megjithatë, përgjatë vitit 2021, numri i aplikimeve u rrit në mënyrë të ndjeshme.

### 3.3.3. Projektet sipas sektorëve strategjikë

Projektet e shqyrtuara përgjatë vitit 2021 i përkasin kryesisht sektorit të turizmit, i cili ka numrin më të madh të projekteve të investimit, duke u ndjekur më pas nga sektori i "zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik (TEDA)".

| VITI                | 2020  |           | 2021  |           |
|---------------------|-------|-----------|-------|-----------|
|                     | Total | Miratuara | Total | Miratuara |
| Projekte            | 7     | 5         | 22    | 17        |
| Turizëm*            | 5     | 3         | 19    | 17        |
| Bujqësi dhe peshkim | 1     | 1         | 1     | 1         |
| Energji             | 0     | 0         | 1     | 1         |
| TEDA**              | 1     | 1         | 1     | 1         |

\* Sqarohet se ndër 19 projektet e miratuara në sektorin e turizmit, 1 projekti i është miratuar statusi përfundimtar dhe 1 projekti i është shtyrë afatit i statusit.

\*\* Sqarohet se bëhet fjalë për të njëjtin projekt investimi TEDA, i cili ka fituar statusin me potencial strategjik në vitin 2020, por në vitin 2021 ka fituar statusin strategjik përfundimtar.

Nëse analizojmë më konkretisht numrin e projekteve sipas sektorëve, më poshtë evidentohen projektet në sektorët strategjikë të shpërndarë përgjatë këtyre dy viteve të fundit.

Në vitin 2020 janë shqyrtuar:


- 5 projekte në sektorin e turizmit
- 1 projekt në sektorin "Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA)"
- 1 projekt në bujqësi
- Në vitin 2021 janë shqyrtuar:

19 projekte në sektorin e Turizmit (prej të cilëve 2 janë projekte ekzistuese me status ku: 1 ka përfutur statusin përfundimtar dhe 1 ka

përfutur shtyrjen e afatit të statusit)


- 1 projekt në sektorin e Bujqësisë dhe Peshkimit
- 1 projekt në sektorin e TEDA, i cili në fakt është projekti që në vitin 2020 ka fituar statusin me potencial strategjik, kurse në vitin 2021 përfutur statusin strategjik përfundimtar.

Të shprehura në formë grafike:




Në vitin 2020 shihet se 60 % e projekteve të miratuara i përkasin sektorit të turizmit, një trend, ky i lidhur ngushtë me miratimin e ligjit Nr. 93/2015 "Për Turizmin", dhe akteve nënligjore të dala në dhe për zbatim të tij, të cilët parashikojnë një sërë lehtësirash për zhvillimin e investimeve. Ky trend ka vazhduar edhe në vitin 2021, ku projektet në sektorin e turizmit zënë 85% të projekteve të miratuara në total., ndërkohë që sektorët e bujqësisë, energjisë dhe të zhvillimit ekonomik zënë respektivisht 5 %.

### PROJEKTE TË MIRATUAR NË 2021



Më poshtë, në formë grafike projektet e miratuar në total, sipas sektorëve, për vitet 2020 - 2021.



### 3.3.3.1 Rezultatet si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike

Duke pasur parasysh aplikimin e legjislacionit për investimet strategjike, përgjatë viteve të fundit, përfshirë dhe vitin e vështirë 2020, si dhe shtimin e numrit të investorëve që kërkojnë aplikimin e masave asistuese apo mbështetëse nga AIDA dhe shteti shqiptar, duhet theksuar se ka një vlerësim tepër pozitiv mbi kuadrin ligjor ekzistues, pavarësisht se, në fillimet e zbatimit të tij, investorët mund të kenë qenë edhe skeptikë me efektivitetin e zbatimit të tij. Por sot, është fakt se ky legjislacion është liberal, jo diskriminues për investorët e huaj, si dhe transparent, në drejtim të incentivave dhe programeve sektoriale, me anë të të cilit janë thjeshtëzuar edhe më tej procedurat administrative.

Tashmë, si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike, projektet e investimit që aplikojnë dhe asistohen nga AIDA kanë më shumë lehtësira në marrjen e lejeve zhvillimore, apo lejeve të ndërtimit, kurse masat mbështetëse janë lehtësisht të zbatueshme dhe me procedura të përshpejtuara.

Zbatimi i ligjit përgjatë kësaj periudhe ka krijuar një rrjet komunikimi ndër-institucional shumë funksional. Duhet theksuar se, për herë të parë, në janar 2020, në bazë të procedurave të ligjit për

investimet strategjike, u arrit që një institucion të aplikojë tek AIDA për të kërkuar ndihmën e institucioneve të tjera me qëllim hartimin e një projekti potencial strategjik, i cili në vitin 2021, arriti të përfitojë edhe statusin strategjik përfundimtar.

Së fundmi, përfshirja në ligj e zonave me prioritet zhvillimi, si një sektor strategjik, përbën një mekanizëm akoma dhe më efikas për të akomoduar investime strategjike me impakt të theksuar social dhe ekonomik për zona të veçanta.

## 3.4 Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

### 3.4.1 Hyrje

Drejtoria NVM dhe Projekteve pranë AIDA-s ka si objektiv të ofrojë shërbime për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, promovimit të bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve dhe të mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja. Drejtoria ndihmon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në shfrytëzimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), në Shqipëri luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë kombëtare dhe zhvillimin e vendit, shprehur kjo nëpërmjet treguesve të punësimit në sektorin privat, si dhe në kontributin e të ardhurave kombëtare. Ekonomia shqiptare është e fokusuar kryesisht në aktivitetin tregtar dhe shërbime të tjera. Ndërmarrjet me aktivitet tregtar numërojnë 29,9% ndaj totalit të ndërmarrjeve të regjistruara gjatë vitit 2021.

Rreth 85,6% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të vogla me 1-4 të punësuar dhe kontributi i tyre llogaritet në 21,7% në punësim dhe 17,8% në realizimin e xhiros vjetore. Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar përfaqësojnë 1,7% të totalit të ndërmarrjeve, punësojnë 51,1% të të punësuarve gjithsej, dhe realizojnë 46,5% të totalit vjetor të xhiros.

Në qarqet Tiranë, Durrës dhe Fier janë përqendruar rreth 64,1% e ndërmarrjeve, ndërsa numri më i vogël në qarkun e Kukësit.

Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë 5,6% të ndërmarrjeve gjithsej, krahasuar me 5,1% të ndërmarrjeve aktive në vitin 2020, dhe punësojnë 12,7% të të punësuarve gjithsej.

Gratë menaxhojnë/zotërojnë 31,1% të ndërmarrjeve gjithsej. Aktiviteti "Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave" shënon pjesëmarrjen më të lartë të grave në vendimmarrje, me 41,8%. Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë janë kryesisht ndërmarrje me 1-4 të punësuar. Gratë zënë 45,7% të të punësuarve gjithsej dhe janë fokusuar më së shumti në aktivitetin ekonomik "Shërbime të tjera", me 54,9%. Sektori me përfaqësimin më të ulët të grave është sektori i ndërtimit.

Statistikat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) bazuar në rezultatet e vërtetimit të

Statistikave Strukturore, për vitin 2020, tregojnë se:

- **99,8 %** të ndërmarrjeve aktive janë NVM, e njëjtë si në vitin 2019;
- **81,9 %** e të punësuarve janë të punësuar në NVM nga **81,6 %** që ishte në vitin 2019;
- **79,7 %** të shitjeve neto realizohen nga NVM nga **78,9 %** të realizuara në vitin 2019;
- **74,0 %** të investimeve kryhen nga NVM nga **68,2 %** të kryera në vitin 2019;
- **74,1 %** e vlerës së shtuar realizohet nga NVM nga **72,4 %** që ishte në vitin 2019 (tab 1).

Tab.1 Treguesit kryesorë dhe struktura e tyre sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2020

| Madhësia e ndërmarrjes                 | Ndërmarrjet |      | Të punësuarit |      | Shitjet neto |      | Investimet |      | Vlera e Shtuar |      |
|----------------------------------------|-------------|------|---------------|------|--------------|------|------------|------|----------------|------|
|                                        | nr.         | %    | nr.           | %    | mln Lekë     | %    | mln Lekë   | %    | mln Lekë       | %    |
| Gjithsej                               | 102.574     | 100  | 503.986       | 100  | 2.147.799    | 100  | 193.880    | 100  | 548.580        | 100  |
| NVM (1-249 të punësuar)                | 102.405     | 99,8 | 412.514       | 81,9 | 1.711.281    | 79,7 | 143.441    | 74,0 | 406.554        | 74,1 |
| Mikrondërmarrje                        | 95.558      | 93,2 | 186.400       | 37,0 | 481.945      | 22,4 | 25.815     | 13,3 | 121.554        | 22,2 |
| Ndërmarrje të vogla                    | 5.674       | 5,5  | 111.347       | 22,1 | 673.675      | 31,4 | 62.475     | 32,2 | 142.153        | 25,9 |
| Ndërmarrje të mesme                    | 1.173       | 1,1  | 114.767       | 22,8 | 555.661      | 25,9 | 55.151     | 28,4 | 142.847        | 26,0 |
| Ndërmarrje të mëdha (250+ të punësuar) | 169         | 0,2  | 91.472        | 18,1 | 436.518      | 20,3 | 50.438     | 26,0 | 142.026        | 25,9 |

Tre treguesit kryesorë të NVM-ve në Shqipëri, krahasuar me BE-në janë:

- përqindja e NVM është **99,8 %**, i njëjtë me BE;
- përqindja e të punësuarve në këtë grup ndërmarrjesh është **81,9 %** në Shqipëri nga **65,0 %** në BE;
- vlera e shtuar e realizuar nga NVM në Shqipëri përbën **74,1 %** nga **53,0 %** në BE (tab. 2).

Tab.2 Struktura e treguesve kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjeve në Shqipëri dhe BE, 2020

| Madhësia e ndërmarrjes                        | Ndërmarrjet (%) |             | Të punësuarit (%) |             | Vlera Shtuar (%) |             |
|-----------------------------------------------|-----------------|-------------|-------------------|-------------|------------------|-------------|
|                                               | Shqipëri        | BE *        | Shqipëri          | BE *        | Shqipëri         | BE*         |
| <b>Gjithsej</b>                               | <b>100</b>      | <b>100</b>  | <b>100</b>        | <b>100</b>  | <b>100</b>       | <b>100</b>  |
| <b>NVM (1-249 të punësuar)</b>                | <b>99,8</b>     | <b>99,8</b> | <b>81,9</b>       | <b>65,0</b> | <b>74,1</b>      | <b>53,0</b> |
| Mikrondërmarrje (1-9 të punësuar)             | 93,2            | 93,3        | 37,0              | 29,2        | 22,2             | 18,7        |
| Ndërmarrje të vogla (10-49 të punësuar)       | 5,5             | 5,7         | 22,1              | 20,0        | 25,9             | 17,0        |
| Ndërmarrje të mesme (50-249 të punësuar)      | 1,1             | 0,9         | 22,8              | 15,9        | 26,0             | 17,3        |
| <b>Ndërmarrje të mëdha (250+ të punësuar)</b> | <b>0,2</b>      | <b>0,2</b>  | <b>18,1</b>       | <b>35,0</b> | <b>25,9</b>      | <b>47,0</b> |

\*27 shtete

Tregtia e jashtme e mallrave në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), 2020:

- **2,6 %** e NVM eksportojnë mallra nga **3,1 %** që eksportuan në vitin 2019;
- **10,1 %** e NVM janë importuese nga **10,8 %** që ishin në 2019;
- Rreth **9,7 %** e shitjeve neto të NVM shkojnë për eksport;
- Ndërmarrjet e mesme kryejnë përqindjen më të lartë të eksporteve me **17,6 %** të shitjeve neto të realizuara prej tyre;
- Mikrondërmarrjet eksportojnë vlerën më të ulët ku rreth **3,1 %** të shitjeve neto janë eksportuar;
- Mikrondërmarrjet kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor me **69,7 %**. Ndërmarrjet e vogla kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e ndërtimit me **31,4 %**. Ndërmarrjet e mesme kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e industrisë përpunuese me **37,3 %**;
- Mikrondërmarrjet kanë përqindjen më të lartë të vlerës së shtuar në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor me **55,9 %**. Ndërmarrjet e vogla kanë përqindjen më të lartë në sektorin e tregtisë me **36,8 %**. Ndërmarrjet e mesme kanë përqindjen më të lartë të vlerës së shtuar në sektorin e industrisë përpunuese me **35,5 %**.



### 3.4.2 Roli AIDA-s në mbështetjen e subjekteve NVM

#### 3.4.2.1 Fondet dhe Aksesin në Financë

Gjatë vitit 2021, fondet e menaxhuara nga AIDA u pezulluan me qëllim për t'ju përshtatur sa më mirë nevojave dhe kërkesave të biznesit.

AIDA dhe një grup pune i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe ekspertë të TAIEK, punuan së bashku për hartimin e skemës së re në mbështetje të NMVM-ve shqiptare dhe miratuan ndryshimet që erdhën nga reagimet e komunitetit të biznesit, direktivat e BE-së dhe rekomandimet e ekspertëve.

Gjithashtu, për arsye legjislative Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me AIDA-n dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të ekosistemit, hartuan ligjin e ri të NMVM-ve, në mënyrë që të përcaktohen ligjërisht se cilat janë mjetet mbështetëse për NMVM-të.

Në momentin që thirrjet për aplikim do të jenë të hapura, AIDA do të zhvillojë një fushatë gjithëpërfshirëse me qëllim promovimin e fondeve dhe informimin e të gjithë bizneseve të interesuara. Bizneset do të mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm në kanalet e komunikimit të agjencisë, lidhur me kriteret dhe rregullat e aplikimit.

#### 3.4.2.2 Platforma "Akses në Financë"

Misioni i AIDA-s, në kuadër të mbështetjes së sipërmarrjeve shqiptare, është të nxisë aftësinë konkurruese të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme shqiptare, nëpërmjet shërbimeve në ndihmë të biznesit vendas, nëpërmjet rritjes së aftësisë konkurruese të NVM-ve shqiptare dhe zhvillimin e tyre, nxitjes së rinovimit, progresit teknologjik dhe shkëmbimeve të informacionit, duke i bërë ato më tërheqëse për tregun e huaj, mbështetjes ndaj sipërmarrësve shqiptarë dhe partnerëve të huaj që dëshirojnë të hyjnë në partneritet me kompani shqiptare nëpërmjet shërbimeve kryesore, siç është: dhënia e granteve të Qeverisë Shqiptare, identifikimi i tregjeve ose partnerëve të rinj për eksport, nevojat për trajnim dhe për certifikim produkti, le-

htësimin e pjesëmarrjes në panaire kombëtare/ndërkombëtare, si dhe mbështetje nëpërmjet projekteve të ndryshme me donatorë vendas dhe të huaj.

"Akses në Financë" <https://aida-smefinance.gov.al/>, është një portë unike për biznesin vendas, duke ofruar informacion të përditësuar mbi mundësi e burime financiare, grante, kredi apo nisma të tjera financuese. Kjo platformë online ofron shërbimin "one-stop-shop" me informacione që lidhen drejtpërdrejt me aksesin në financë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), i cili ofrohet nga institucione, organizata apo kompani të ndryshme private dhe publike, kombëtare e ndërkombëtare.

Ndërtimi i platformës "Akses në Financë" është bërë i mundur me rekomandimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si edhe me mbështetjen e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Brenda Kornizës së Përgjigjes së Shpejtë Këshilluese, si dhe në mënyrë që të mbështesë mobilizimin e shpejtë dhe shpërndarjen me kosto efektive, BERZH ka siguruar mbështetje afatshkurtër për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

AIDA, si zbatuesja kryesore e kësaj nisme, ka ndjekur, asistuar dhe dhënë kontribut të vazhdueshëm gjatë krijimit të platformës, në bashkëpunim me kompaninë zhvilluese të saj.

Platforma u lançua gjatë muajit maj 2021 dhe aktualisht përditësohet periodikisht nga AIDA me thirrje të reja dhe mundësi financimi për NVM-të, njëkohësisht duke asistuar dhe dhënë përgjigje rast pas rasti dhe sipas nevojës së kompanive të interesuara për të aplikuar.

Për periudhën maj – dhjetor 2021, në platformë janë publikuar gjithsej 64 thirrje për aplikim për grante ose kredi. Gjithashtu, platforma është vizituar 13,263 herë në total.

Prej muajit maj – dhjetor 2021, platforma ka patur 2220 përdorues, nga të cilët 2200 kanë qenë përdorues të rinj.



Mesatarisht në platformë publikohen 4 thirrje të reja në muaj. Nga shkalla e frekuentimit, vihet re se thirrjet e vizituara më shpesh janë ato që kanë në fokus inovacionin dhe teknologjinë.

Mosha mesatare e vizitorëve është 25-34 vjeç, me një përqindje prej 33.5% dhe më pas vijnë vizitorët e moshës 18-24 vjeç me një përqindje prej 27.5%. Vizitorët e platformës janë më së shumti nga Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italia dhe Kosova.

Për të marrë buletin elektronik të thirrjeve deri tani janë regjistruar gjithsej 142 subjekte, ku prej tyre janë 72 NVM dhe 70 persona fizik.

### 3.4.2.3 Platforma “Business to Business”

Platforma “Business to Business” (B2B), është një rrjet aktiv, i cili ofron mundësinë për bashkëpunime dhe investime të suksesshme midis bizneseve. Kjo platformë është një “mekanizëm” lehtësues që krijon mundësi për bashkëpunime frytdhënëse dhe për të zgjeruar kontaktet në botën e biznesit. Në platformën online B2B të faqes së AIDA-s, në fund të vitit 2021 kanë qenë në total të publikuar 959 profile të kompanive shqiptare, me qëllim vizibilitetin e kompanive ndaj partnerëve potencialë për krijimin e kontakteve dhe zhvillimin e biznesit.

Për t’u njohur me platformën B2B vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/b2b/>

### 3.4.2.4 Hartimi i strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2021 – 2027

Në kuadër të rinovimit të Strategjisë të Biznesit dhe Investimeve (BIDS), për periudhën e re 2021-2027, AIDA ka qenë pjesë e rëndësishme e grupit të hartimit të saj. Gjatë 6-mujorit të parë të vitit, AIDA ka dhënë kontributin e saj në hartimin dhe finalizimin e kësaj strategjie, si një nga zbatuesit kryesorë të saj, pas hyrjes në fuqi. AIDA është pjesë e zbatimit të 10 prioriteteve kryesore të strategjisë, konkretisht:

**Objektivi specifik 1.2:** Zhvillimi i NMVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni, prioritetet: Skema e mbështetjes së sipërmarrjes së bazuar në konkurrencë, Nisma për ngritjen e zinxhirit të

vlerës së bazuar në konkurrencë; Rritja e aksesit në financë e NMVM-ve; Programi i aftësive të ndërmarrjeve për NVM-të,

**Objektivi specifik 1.3:** Zhvillimi i kapitalit njerëzor, prioritetet: Skema e mbështetjes për zhvillimin bashkëpunues të kapitalit njerëzor. Programi i zhvillimit të forcës së punës për dhe me NMVM-të dhe investorët; Sistemi i parashikimit të nevojave të aftësive; Vlerësime të rregullta të nevojave për trajnim.

### 3.4.2.5 Nisma të tjera në kuadër të zhvillimit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme

- U ngrit grupi i punës për zhvillimin e nismës ‘Zhvillimi i Tregtisë Elektronike’ në bashkëpunim me Bankën Botërore, për hartimin e Guidës *E-commerce*, pyetësorit ‘Self Assessment Tool’ dhe trajnimeve të dedikuara specifiku kësaj nisme. Deri në fund të vitit 2021, u mbyll me sukses draftimi i Guidës *E-commerce*.
- AIDA ka qenë partnere në projektin Sfidë IDEA duke asistuar në të gjitha fazat e zhvillimit të tij, që prej promovimit, vlerësimit të planeve të biznesit dhe shpallja e finalistëve. Gjatë vitit 2021, rreth 300 *start-up* inovative morën iniciativën për të forcuar kompetencat e tyre sipërmarrëse dhe aftësitë e biznesit, nëpërmjet gjenerimit të ideve dhe zhvillimit të planeve bindëse të biznesit.

### 3.4.2.6 Pjesëmarrje në forume dhe webinarë

- Pjesëmarrje në takimin online me përfaqësues të Bankës Botërore, për projektin *Blue Economy*.
- Pjesëmarrje në takimin online me përfaqësues të Bankës Botërore, për projektin e politikave të zhvillimit të konkurrencës.
- Pjesëmarrje në takimin online me sekretariatit e Këshillit të Investimeve për Inovacionin në Sipërmarrje.
- Pjesëmarrje dhe feedback në takimin “SME Digitalisation Report”, IDRA, BERZH, MFE, AIDA.
- Takim me përfaqësues të AADF për realizimin e projekteve të përbashkëta.

- Takim me përfaqësues të *Oficina Innovation Hub* mbi bashkëpunimin e aktiviteteve.
- Pjesëmarrje në takimin online me Risi Albania “*Digital Economy in Albania*”.
- Pjesëmarrje në takimin e “*Tirana Inc. presented to Albanian eco-system actors*”.
- Bashkëpunim me INSTAT në kuadër të shkëmbimit të informacionit.
- Ndjekje e takimit me përfaqësues të Bankës Botërore për “*Digital Trade Project – SME digitalization/e-commerce trainings*”.
- Takim online me *Export Acceleration Program and RGX Trade Intelligence*.
- Pjesëmarrje në takimin online me përfaqësues të EBRD, në lidhje me mundësitë për bashkëpunim për vitin 2022.
- Pjesëmarrje në takime konsultative me ekspertë të OECD mbi kontributin në *dimensioned SBA*.
- Pjesëmarrje në takimin e aktorëve të ekosistemit të *start up-eve* dhe inovacionit, organizuar nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
- Takim online me përfaqësues të EBRD për mundësi bashkëpunimi për aktivitetin me fokus NVM-të në Agroturizëm.
- Takim me përfaqësues të EBRD mbi mundësinë e bashkëpunimit në kuadër të prioriteteve të BIDS 2021-2027.
- Pjesëmarrje në takimin online mbi përditësimet e Analizës së Mangësive Ligjore dhe Analizës së Mangësive Institucionale e Administrative (*LGA +IAGA*) për kapitullin 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”.
- Takim online për Reformën ERP midis përfaqësuesve të BE, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe AIDA.
- Pjesëmarrje në takimin përgatitor për mbledhjen e Nënkomitetit “TTID”.
- Pjesëmarrje në takimin online: Nënkomiteti “Tregti, Industri, Tatime e Dogana”.
- Pjesëmarrje në takimin online me Risi Albania “Bimët medicinale dhe Aromatike & COVID-19: Një kohë e mirë për të investuar?”
- Pjesëmarrje në takimin online me Risi Albania “*Digital Economy in Albania*”.
- Pjesëmarrje në grupin përgatitor dhe dhënie kontributi në hartimin e projektligjit të ri për NVM-të.
- Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021 – 2027.
- Përditësim i statusit të përmbushjes së aktiv-

iteteve në rekomandimet e dhëna nga shërbimet e BE në Nënkomitetin për “Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet”.

- Pjesëmarrje në takimin online të GNPIE së kapitullit “Kriteri Ekonomik”.

### 3.4.3 Projekte të menaxhuara nga AIDA

#### 3.4.3.1 Menaxhimi dhe zbatimi i projektit “Enterprise Europe Network”

Rrjeti European i Ndërmarrjeve (*Enterprise Europe Network*), është rrjeti më i madh në botë, i cili mbështet Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) me synim inovacionin dhe rritjen e tyre në shkallë ndërkombëtare. Ky rrjet u financua nga programi *COSME* (Konkurrueshmëria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme), një program i financuar nga Bashkimi European, i krijuar për të inkurajuar konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve evropiane.

Gjatë periudhës 2020-2021, Konsorciumi Shqiptar i *Enterprise Europe Network* përbëhej nga AIDA, në cilësinë e partnerit udhëheqës dhe tre partnerët: Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCIT), Instituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen (IPPM) dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL).

Në kuadër të objektivave të projektit gjatë vitit 2021 janë realizuar:

- Takime periodike me partnerët e Konsorciumit me qëllim koordinimin e Konsorciumit;
- Pjesëmarrje në 36 trajnime online, forume dhe konferenca të organizuara nga EISMEA dhe partnerët e Rrjetit;
- Bashkëorganizimi i 47 aktiviteteve me qëllim arritjen e rezultateve të projektit.
- Përgatitje dhe publikim katalogut e “*Enterprise Europe Network Albania’s POD Profiles*”, me profilet e sipërmarrjeve shqiptare dhe shpërndarja në databazën e rrjetit;
- Përgatitje dhe publikim periodik të newsletter-it elektronik me qëllim informimin mbi aktivitetet e zhvilluara;
- Përgatitje dhe publikim i pyetësorit “*SME Feedback*”, drejtuar sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare (NVM), të cilat janë të përfshira ose synojnë tregjet ndërkombëtare;
- Përgatitje e 18 profileve të reja të kompanive

kompanive shqiptare;

- Realizim i 60 shprehjeve të interesi të ardhura për krijimin e kontakteve të reja nga kompani të huaja dhe 17 kërkesa të bëra për partnerët e huaj, në emër të kompanive shqiptare.

Marrëveshje Partneriteti u lidhën 4 kontrata të reja, përkatësisht:

1. “Vigan Group” dhe “Trokit”
2. “Alb Market” dhe “Delight LLC”
3. “Dua Punë” dhe “Portal Pune”
4. “Sdrava” dhe “Jege Foods”

### 3.4.3.2 Menaxhimi dhe zbatimi i projektit “FILA”

Projekti “FILA” u bashkëfinancua nga BE dhe u zbatua në kuadër të programit ndërkufitar Interreg IPA Itali-Shqipëri-Mal i Zi, për një periudhë 2-vjeçare 01.04.2018 – 01.04.2020, por për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, kohëzgjatja e projektit u shty deri në

01.01.2021.

Objektivi kryesor i tij është rritja e konkurrueshmërisë së NVM-ve dhe bashkëpunimit ndërkufitar duke forcuar lidhjen ndërmjet kërkimit dhe bizneseve përmes krijimit të tre laboratorëve ndërkufitarë të fertilizimit dhe inovacionit në sektorin agrourbues në Shqipëri (Korçë), Mali i Zi (Niksic-Tehnopolis) dhe Puglia (Bari - CIHEAM), bazuar në modelin FILA.

Në kuadër të këtij projekti gjatë vitit 2021 u realizua:

- Raportimi final për projektin “FILA”;
- Raportimi vjetor për projektin “FILA”, për gjendjen e llogarisë, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Raportim për shpenzimet e realizuara gjatë kohës së zhvillimit të projektit, 2018 – 2020, për stafin pjesëmarrës në projekt;
- Realizim mujor i raportimeve mbi gjendjen e llogarive financiare të projektit, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

## 4 DREJTORIA MARKETING DHE KËRKIM ANALIZË

### 4.1. Hyrje

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka për funksion sigurimin e Komunikimit dhe Marketingut të institucionit për politikën, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj. Po ashtu, kjo drejtori ka për funksion kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik.

Misioni i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë është arritja e objektivit mbi informacionet mbi tregun dhe strategjive të reja, me qëllim kërkimin në vazhdimësi për mundësi të reja investimi në Shqipëri.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë siguron informacione mbi tregun dhe strategjitë e reja, kryen studime tregu dhe kërkim të dhënash me qëllim përditësimin e materialeve dhe informacioneve në funksion të drejtorive dhe investitorëve.

## 4.2. Publikime në media sociale

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka mundësuar funksionimin e pandërprerë, përditësimin me informacion, si edhe pasqyrimin në kohë të tij, në të gjitha kanalet e komunikimit (*Website, Facebook, Instagram, LinkedIn, Twitter*). Të gjitha aktivitetet, takimet zyrtare, konferencat, trajnimet, panairët, etj., janë pasqyruar në faqen *Web* dhe në Rrjetet Sociale nëpërmjet një lajmi në gjuhën shqipe dhe angleze, si edhe shoqërimit me foto, video, infografe ilustruese etj. Të gjitha postimet në rrjetet sociale janë të shoqëruara me linke nga faqja zyrtare e AIDA-s, në mënyrë që të promovohet faqja zyrtare e institucionit, si edhe për ta bërë më të aksesueshme nga publiku.

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha informacionet mbi veprimtarinë e AIDA-s, grupeve të interesit, investitorëve, partnerëve etj., dhe ka informuar publikun e gjerë nëpërmjet mediave elektronike dhe faqes zyrtare [www.aida.gov.al](http://www.aida.gov.al) në kohë reale. Një rëndësi të veçantë i është kushtuar organizimit të aktiviteteve dhe përmirësimit të imazhit duke siguruar që të dhënat, lajmet dhe materialet promovuese të Agjencisë të shpërndahen në mënyrë periodike nëpërmjet rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të internetit.

### AIDA Website

Faqja *web* e AIDA-s, përmban informacione të rëndësishme në ndihmë të investitorëve, kompanive vendase, si edhe ato të huaja. Website përmban rubrikat kryesore me kategorizime përkatëse, të cilat ju përshtaten karakteristikave të audiencës. Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë është angazhuar në menaxhimin dhe përditësimin e përmbajtjes së faqes zyrtare të web-it të Agjencisë, [www.aida.gov.al](http://www.aida.gov.al), kontenti i së cilës ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Përditësimi i faqes zyrtare bëhet në baza të rregullta duke reflektuar praktikën më të mira ndërkombëtare dhe nëpërmjet një marketing miks synon tërheqjen e një numri në rritje të investitorëve potencialë për të vizituar faqen.

### 4.2.2 Rrjete sociale

AIDA mbulon me informacione edhe nëpërmjet rrjeteve sociale, për t'ju ardhur në ndihmë të

palëve të interesuara, si dhe për ta bërë më të lehtë marrjen e informacionit. Aktualisht AIDA ka në përdorim faqet: *Facebook - AIDA - Albanian Investment Development Agency, Instagram - @aida\_albania, LinkedIn - AIDA - Albanian Investment Development Agency, Twitter - @investinalbania*.

### AIDA Facebook

Faqja e *facebook* ka një audiencë të lartë, numër i cili ka ardhur duke u rritur vazhdimisht që prej krijimit të faqes në vitin 2016. Faqja *facebook* përditësohet vazhdimisht duke ofruar informacione mbi aktivitetet e ardhshme dhe të zhvilluara, mbi investimet dhe klimën e të bërit biznes, rritjen ekonomike, etj. Për vitin 2021, janë bërë 461 postime.

### AIDA Twitter

AIDA është aktive edhe në rrjetin social *twitter* duke publikuar dhe ndarë me ndjekësit informacione të rëndësishme. Për vitin 2021, janë bërë 203 postime gjithsej.

### AIDA Instagram

Profil i ri i AIDA-s në *instagram* u krijua përgjatë vitit 2019, duke krijuar një rritje dhe njohje nga një masë me e gjerë e shërbimeve dhe rolit të institucionit. Për vitin 2021, janë bërë gjithsej 410 publikime.

### AIDA LinkedIn

AIDA ka aktualisht dhe një faqe në rrjetin social *LinkedIn* për të qënë më afër ndjekësve të saj. Për vitin 2021, në rrjetin social *LinkedIn* janë bërë 291 postime gjithsej.

Faqja zyrtare AIDA-s, së bashku me rrjetet sociale (*Facebook, Twitter, Instagram, LinkedIn*), kanë qënë shumë aktive dhe një asistencë e rëndësishme për të gjithë aktorët dhe bizneset të cilët vizitojnë faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të AIDA-s, për t'u njohur në kohë reale me të gjitha informacionet e pasqyruara.

Në total, në të gjitha adresat e AIDA-s janë bërë 1364 postime.

### 4.2.3 Prezantimet video

Përgjatë vitit 2021, AIDA ka publikuar 13 video. Përgatitja e formateve video ka si qëllim të japë një mesazh dhe njohë kompanitë NMVM, në mënyrë konkrete dhe për ta bërë sa më të prekshme, ndihmën që AIDA ofron nëpërmjet menaxhimit të fondeve.

Këto video gjithashtu trajtojnë çështje dhe ndajnë eksperiencat mbi mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij, video të aktiviteteve të veprimtarisë së AIDA-s, vizitave në kuadër të monitorimit të fondeve, prezantimit dhe informimit mbi shërbimet *EEN-Albania*, si edhe video të Pavijonit të Shqipërisë në *Expo 2020 Dubai*.

#### 4.2.3.1 Video të përfituesve të fondeve të menaxhuara nga AIDA

AIDA ka zhvilluar disa takime monitoruese të kompanitë përfituese të fondeve të menaxhuara nga AIDA të cilat janë: *Lea 2011 Sh.p.k, Sejega Sh.p.k, KITI Tekstil, F&L Sh.p.k, Natyral & ATC, Kantinën "Bardha", Rozeta Murati (PF), Life on a Boat (PF)*, ku u njoh më nga afër me vijimësinë e biznesit pas vënies në përdorim të fondeve të përfituara.

- [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=5457498480991872&id=269159649825807](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=5457498480991872&id=269159649825807)

Kompania LEA 2011- Përfitues i Fondit të Konkurrueshmërisë

- <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/1096033330892576>

Kompania Sejega SHPK- Përfitues i Fondit të Konkurrueshmërisë

- <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/4480583385303816>

Kompania KITI Tekstil - Përfitues i Fondit të Konkurrueshmërisë

- Kompania F&L SHPK - Përfitues i Fondit të Konkurrueshmërisë

<https://www.facebook.com/investinalbania/videos/125696969484304>

- <https://www.facebook.com/investinalbania/posts/5240523472689375>

Rozeta Murati (PF) - Përfituese e Fondit të Ekonomisë Kreative

- <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/785943129025574>

Kompania Natyral & ATC-Përfitues i Fondit të Konkurrueshmërisë.

- <https://www.facebook.com/investinalbania/posts/175441417922589>

Kantina "Bardha"-Përfitues i Fondit të Konkurrueshmërisë

#### 4.2.3.2 Video në kuadër të projektit EEN Albania

- <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/875612193013264>

Webinari "E-commerce | Inovacion dhe zhvillim për bizneset"

- <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/200768334906581>

Histori suksesi EEN-Albania & AIDA, vizitë pranë Life on a Boat

- <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/283641586591049>

Webinari: Si të hartoni profilin e biznesit tuaj - hapi i parë drejt tregut europian

#### 4.2.3.3 Video prezantimi të platformës "Akses në Financë"

- <https://www.facebook.com/investinalbania/posts/168720981927966>

Takimit online, ku prezantohet platforma "Akses në Financë"

- <https://www.facebook.com/investinalbania/posts/164147625718635>

Video promovuese e platformës "Akses në Financë"

#### 4.2.3.4 Video mbi pjesëmarrjen në Expo 2020 Dubai

- <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/438744874399449>

Pavijoni i Shqipërisë në *Expo 2020 Dubai*



## 4.3 Botimet e AIDA-s

Përgjatë vitit 2021, në kuadër të rritjes së vizibilitetit dhe informimit, AIDA ka hartuar dhe dizenuar materiale promovuese (digjitale dhe fizike), për të gjithë sektorët kyç të vendit me fokus investitorët potencialë dhe kompanitë NMVM, të cilat ju vijnë në ndihmë me informacione, si edhe promovimit të veprimtarisë së AIDA-s në aktivitetet pjesëmarrëse.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë në bashkëpunim me drejtoritë e tjera siguroi përditësimin e materialeve dhe u kujdes për përshtatjen, dizenjimin, botimin dhe vendosjen e tyre në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, për t'i bërë sa më të aksesueshme.

### 4.3.1 Botime sektoriale për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme



#### SEKTORI I TEKSTILEVE

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/944-sektori-i-tekstileve>

Broshura pasqyron zhvillimin e sektorit të tekstilit në Shqipëri nëpërmjet statistikave të viteve të fundit, kontributet e sektorit, si edhe avantazhet e operimit në këtë sektor.



#### SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK)

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1003-sektori-i-tik>

Ky botim është një përmbledhje e sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Shqipëri, avantazhet, historitë e suksesit, si dhe mbështetja e sektorit nga shteti dhe AIDA.



#### SEKTORI I LËKURËS DHE KËPUCËS

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/947-sektori-i-lekures-dhe-kepuces>

Broshura është një përmbledhje e sektorit të lëkurës dhe këpucës në Shqipëri në të gjitha dimensionet, duke përfshirë rëndësinë dhe mbështetjen e sektorit nga shteti dhe AIDA.





## SEKTORI I PIJEVE DHE USHQIMIT

[https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Industira\\_e\\_pijeve\\_dhe\\_ushqimit.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Industira_e_pijeve_dhe_ushqimit.pdf)

Broshura pasqyron zhvillimin e sektorit të industrisë së pijeve dhe ushqimit në Shqipëri dhe mbështetjen e ofruar nga shteti dhe AIDA.



## SEKTORI I FRUTA-PERIMEVE

[https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/fruta\\_dhe\\_perime\\_.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/fruta_dhe_perime_.pdf)

Broshura "Sektori i Fruta-Perimeve" është përmbledhje e zhvillimit të sektorit në Shqipëri dhe kontributi i tij në ekonominë e vendit.



## EKONOMIA E USHQIMIT- BUJQËSIA

<https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Bujqesia.pdf>

Kjo broshurë ju njeh me: mekanizmin, inovacionin dhe digjitalizimin në sektorin e bujqësisë, blegtorinë, peshkimin, agrobiznesin, agropërpunimin, bimët mjekësore dhe aromatike, bletarinë, agroturizmin, agropylltarin dhe mjedisin në zonat rurale.



## SEKTORI I BIMEVE MJEKËSORE AROMATIKE

[https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Sektori\\_i\\_bimeve\\_mjekesore\\_aromatike.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Sektori_i_bimeve_mjekesore_aromatike.pdf)

Broshura ofron një përmbledhje të sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në Shqipëri nëpërmjet statistikave të viteve të fundit, proceseve të punës, produktet dhe shërbimet kryesore, avantazhet e sektorit, historitë e suksesit, etj.

### 4.3.2 Botime për promovimin e Investimeve Strategjike



#### BROSHURA "FACTSHEET: SEKTORI I TURIZMIT 2021"

[https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/TourisM\\_Fact-Sheet.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/TourisM_Fact-Sheet.pdf)

Broshura "Sektori i Turizmit" prezanton ecurinë e zhvillimit të sektorit në vendin tonë, incentivat që po ndërmerren qeveria në ndihmë të investitorëve potenciale dhe atyre ekzistues dhe rendit arsyet përse duhet të investojmë në këtë sektor.



#### BROSHURA "FACTSHEET: SEKTORI I MANIFAKTURËS 2021"

[https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Manufacture\\_FactSheet\\_2021.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Manufacture_FactSheet_2021.pdf)

Broshura "Sektori i Manufakturës në Shqipëri", prezanton sektorin e manufakturës në vendin tonë, incentivat që ka ndërmarrë qeveria dhe përse duhet të investojmë në këtë sektor.



#### BROSHURA "FACTSHEET: SEKTORI I ICT DHE BPO 2021"

[https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Ict\\_BPO\\_Fact-Sheet2021\\_.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Ict_BPO_Fact-Sheet2021_.pdf)

Broshura "Sektori i ICT dhe BPO" bën një prezantim të zhvillimit të sektorit në Shqipëri dhe arsyet përse duhet të investojmë.



#### BROSHURA "FACTSHEET: "SEKTORI I AGRICULTURËS, AGROTURIZMIT DHE AKUAKULTURËS 2021"

[https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Agriculture\\_Fact-Sheet.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Agriculture_Fact-Sheet.pdf)


Broshura përmban një pasqyrë të Sektorit të Agrikulturës dhe nënsektorët e tij në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe skemat ekzistuese që mbështesin zhvillimin e sektorit.



### BROSHURA "ALBANIA CALLS - A COUNTRY OF OPPORTUNITIES 2021"

[https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Albania\\_Calls\\_2021.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Albania_Calls_2021.pdf)

Broshura përmban informacione të përditësuara për vitin 2021, mbi arsyet kryesore për të investuar në Shqipëri, klimën e biznesit, marrëveshjet e tregtisë së lirë, baza ligjore për investimet e huaja dhe indikatorët makroekonomik.




### BROSHURA "BRING YOUR BUSINESS TO ALBANIA 2021"

[https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Bring\\_Your\\_Business\\_in\\_Albania\\_2021.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Bring_Your_Business_in_Albania_2021.pdf)

Ky botim në gjuhën angleze përmban informacione të përditësuara për vitin 2021, mbi arsyet pse të investosh në Shqipëri dhe përshkruan në mënyrë konkrete ligjin mbi investimet strategjike dhe incentivat për sektorët me potencial zhvillimi si: Energjia, Turizmi, Agroturizmi, Manifaktura, Agrikultura dhe Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA). Ky botim i AIDA-s i drejtohet të gjithë investitorëve potencialë dhe prezanton lehtësirat e të bërit biznes në Shqipëri.

#### 4.3.3 Botime të tjera



### RAPORTI VJETOR 2020

<https://aida.gov.al/images/PDF/Raport%20vjetor%202020.pdf>

Raporti Vjetor 2020, prezanton ecurinë e zhvillimeve përgjatë vitit 2020, të arritjeve dhe punës së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe në mënyrë specifike të drejtorive në përbërje të saj.



## REVISTË ELEKTRONIKE NUMËR 1, 2, 3 DHE 4 PËR VITIN 2021

1. [https://aida.gov.al/images/Publikime/NewsletterT1\\_2021.pdf](https://aida.gov.al/images/Publikime/NewsletterT1_2021.pdf)
2. [https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/NewsletterT2\\_2021.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/NewsletterT2_2021.pdf)
3. [https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Newsletter\\_korrik\\_shtator\\_2021.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Newsletter_korrik_shtator_2021.pdf)
4. [https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/NewsletterTetor-dhjetor\\_2021.pdf](https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/NewsletterTetor-dhjetor_2021.pdf)

Këto publikime shërbejnë si një kornizë pasqyrimi për të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2021. Revista elektronike ka si synim të rrisë ndërveprimin e AIDA-s me partnerët, bashkëpunëtorët dhe aktorët e interesit.



Katalogu i produkteve “*Made in Albania*” për periudhën Korrik-Dhjetor 2020

<https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Katalogu.pdf>

Në këtë botim do të gjeni një përmbledhje të produkteve “*Made in Albania*”, për periudhën Korrik 2020 - Korrik 2021.

## 4.4 Nisma të AIDA-s

### 4.4.1 Fushata ‘Zgjdh të vendit’

‘Zgjdh të vendit’ është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘*Made in Albania*’. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2021, është realizuar promovimi në rrjetet sociale të institucionit i 113 produkteve lokale. Në kuadër të nismës për promovimin e produkteve “*Made in Albania*”, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve publikoi “Zgjdh të Vendit”, katalogun e parë të produkteve “*Made in Albania*”. Katalogu prezanton në përmbajtjen e tij 94 produkte për periudhën korrik 2020 - korrik 2021. Pas prezantimit të katalogut, AIDA ka promovuar në rrjetet e saj sociale, edhe 19 produkte të tjera të reja.

### 4.4.2 Fushatë mbi ndërgjegjësimin dhe zhvillimin e biznesit elektronik (e-commerce)

Në vitin 2021, AIDA ndërmorri nismën për zhvillimin e biznesit elektronik, kjo si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe nevojës që kishin bizneset NMVM për të operuar online. Në kuadër të zbatimit dhe përgatitjes për realizimin e iniciativës së zhvillimit të biznesit elektronik, referuar Strategjisë së Zhvillimit të Bizneseve dhe Investimeve 2021-2027, AIDA realizoi disa takime me përfaqësues të Bankës Botërore, të cilët ndihmuan me asistencë teknike në disa drejtime. Më konkretisht në: përgatitja e guidës/materialit mbi e-commerce, përgatitja e “*self assessment tool*” dhe realizimi i tij, organizimi i një fushate promovuese në të gjithë Shqipërinë për rritjen e ndërgjegjësimin të NMVM-ve në lidhje me përdorimin dhe përfitimet e e-commerce. Gjatë vitit 2021, u realizua kërkimi dhe organizimi i informacioneve, si dhe përgatitja e draftit mbi guidën e-commerce. Kjo nismë do të vijojë edhe në vitin 2022, ku do të publikohet guida në ndihmë të bizneseve, duke vazhduar me trajnimet e NMVM-të për tregtinë elektronike.



## 5 AIDA NË AKTIVITETE

### 5.1 Aktivitete lokale me qëllim mbështetjen dhe informimin e biznesit

Agjencia, në funksion të veprimtarisë së saj, ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e bashkëpunuar me organet shtetërore. Agjencia, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, siguron të dhëna të nevojshme për bizneset dhe mundëson përhapjen e tyre, nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti shkëmbimi të informacioneve.

Përgjatë këtij viti AIDA ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme aktivitete, seminare informuese dhe takime derë më derë me bizneset, me qëllim informimin e tyre mbi shërbimet kryesore që AIDA ofron.

#### Info Day

Seminar informues (Info day), u organizua në qarkun e Beratit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Bashkinë e Beratit dhe me pjesëmarrjen e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim (BERZH), CEFE International, CoSolve (Projekt i Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar -GIZ), më datë 18 qershor 2021. Info day e organizuar nga AIDA, kishte si fokus mbështetjen e biznesit vendas me asistencë teknike dhe financiare dhe pjesëmarrja ishte një mundësi frytdhënëse për të bashkëbiseduar, për t'u informuar, si edhe për të qenë në kontakt direkt me institucione që kanë politika të dedikuara për zhvillimin e bizneseve.

#### Takime dhe vizita

Gjithashtu, AIDA ka realizuar gjatë vitit 2021, takime në kompanitë: *Sejega sh.p.k*, *Kiti Tekstil*, *Kantina "Bardha"*, *TOK Digital Agency* dhe *Anila*

*Hoxha, Person Fizik*, në qytetin e Tiranës. *F&L shpk*, *Anila Hoxhaj Person Fizik dhe Rozeta Murati Person Fizik*, në qytetin e Fierit. Tre vizita në qytetin e Vlorës pranë personave fizik: *Ana Sheraj*, *Adnan Zanaq dhe subjektit Konserva Vlora*, si dhe tre vizita në Durrës në ambientet e kompanive: *ATC Natyral*, *Lea 2011 shpk* dhe *Renato Pajo P.F.*

Në kuadër të aktivitetit të organizuar në bashkëpunim me Dhomën Ekonomike të Gruas në qytetin e Përmetit, AIDA ka zhvilluar prezantime dhe takime me biznesin e këtij qyteti.

AIDA ka realizuar edhe një vizitë pranë kompanisë "*Doni Fruits*" në qytetin e Lushnjës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Investimeve. Gjatë takimit, përfaqësuesit e AIDA-s informuan bashkëpronarët e kompanisë për aktivitetet mbështetëse që Agjencia ofron, mundësitë dhe lehtësirat për nxitjen e eksporteve.

### 5.2 Panairët dhe roli i AIDA-s në mbështetjen ndaj bizneseve

Pjesëmarrja e bizneseve shqiptare në panaire jashtë vendit është një mbështetje e veçantë në përpjekjet e qeverisë shqiptare, nëpërmjet AIDA-s për të nxitur biznesin vendas dhe veçanërisht atë eksportues.

AIDA nëpërmjet mbështetjes apo organizimit të pjesëmarrjes në panaire synon promovimin e biznesit shqiptar në sektorë specifikë, mundësimin e takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet dhe mbështetjen e kompanive shqiptare me logjistikë për takimet e planifikuara, rritjen e eksportit në këtë sektor, tërheqjen e investitorëve të huaj për investime në vend dhe promovimin e Shqipërisë.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare, AIDA promovon produktet dhe shërbimet shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për të reklamuar dhe për të lehtësuar eksportin e produkteve "*Made in Albania*".

## 5.2.1 Panaire 2021

### ProSEED Expo

Në datat 24 – 25 nëntor 2021, u zhvillua panairi "*ProSEED Expo*", në sheshin *Italia*, me qëllim promovimin e sipërmarrjeve të reja. AIDA ishte pjesëmarrëse në panair me një info standë, me qëllim informimin e bizneseve rreth shërbimeve mbështetëse që ajo ofron në ndihmë të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Gjatë panairit u prezantuan produktet e rreth 40 sipërmarrësve të rinj.

### Shqipëria Punon Tokën – Shijo produktet lokale

Në datat 22 – 24 tetor 2021, u organizua panairi Shqipëria Punon Tokën – Shijo produktet lokale, në sheshin Skënderbej. AIDA ishte pjesëmarrëse në panair me një info standë, me qëllim informimin e bizneseve dhe të interesuarëve mbi zhvillimin e sektorit dhe organizimin e takimeve për bashkëpunim mes bizneseve pjesëmarrëse. Ky panair shërbeu si një pikëtakim mes prodhuesve agroushqimor dhe jo vetëm, si dhe konsumatorëve me qëllim promovimin e kompanive që operojnë në trevat Shqiptare.

### Panairi Ndërkombëtar i Tiranës

Në datat 1 - 4 dhjetor 2021, u mbajt Panairi Ndërkombëtar i Tiranës, nën tematikën "Ballkani pa Kufij Ekonomikë", në Pallatin e Kongreseve, të organizuar nga *Klik Ekspo Group*. AIDA ishte pjesëmarrëse në panair me një info standë, me qëllim informimin e bizneseve dhe të interesuarëve mbi zhvillimin e sektorit dhe organizimin e takimeve për bashkëpunim mes bizneseve pjesëmarrëse.

## 5.2.2 Bashkëpunime dhe partneritete

- 22-23 prill 2021, AIDA dhe *EEN Albania* në cilësinë e bashkëorganizatorit morën pjesë në *PrishtinaMatch4ICT*, një event biznesi dyditor për sektorin e *ICT*, për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky takim bëri bashkë sipërmarrje nga rajoni, të cilat operojnë në sektorin *ICT* dhe që kishin në fokus zgjerimin në tregje të reja, si dhe krijimin e partneriteteve.
- 25 tetor 2021, AIDA mori pjesë në forumin "Mbajmë Derën Hapur për Sipërmarrësit Shqiptarë", në kuadër të fushatës të quajtur Dita Europiane e Mikrofinancës të organizuar nga Shoqata Mikrofinanca Shqiptare. Forumi promovoi përpjekjet e institucioneve të

mikrofinancës për të mbështetur mikrondërmarrjet dhe biznesin e vogël në kushtet e pandemisë, si dhe për të hedhur dritë mbi strategjitë e sektorit të mikrofinancës në vijimësi në drejtim të partneritetit me bizneset shqiptare.

- 24 nëntor 2021, u organizua finalja e Sfidës *IDEA*, e financuar nga *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* (GIZ) GmbH – nëpërmjet programit *ProSEED*. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve si partnere e Sfidës *IDEA* në këtë projekt, asistoi në të gjitha fazat e zhvillimit të tij. Gjatë vitit 2021, rreth 300 *start-up* inovative morën iniciativën për të forcuar kompetencat e tyre sipërmarrëse dhe aftësitë e biznesit, nëpërmjet gjenerimit të ideve dhe zhvillimit të planeve bindëse të biznesit. Gjatë ceremonisë finale për konkurrentët në qytetin e Tiranës, më 11 Nëntor, u prezantuan gjithashtu edhe shërbimet që AIDA ofron në ndihmë të NVM-ve shqiptare.
- Përgatitja dhe nënshkrimi i memorandumëve të bashkëpunimit me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe me Shoqatën *Pro-Export*, me qëllim bashkëpunimin e mëtejshëm për të nxitur konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e bizneseve.

## 5.3 Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve online

- 21 janar 2021, AIDA në bashkëpunim me partnerin *SIPPO*, organizuan një trajnim/sesion informues përgatitor për kompanitë eksportuese shqiptare, mbi pjesëmarrjen në panairin virtual "*BIOFACH 2021*", si edhe mbi mundësitë që ofron tregu evropian i produkteve organike. Një nga qëllimet kryesore të këtij sesiioni informues ishte evidentimi i nevojave kryesore të kompanive shqiptare, të sektorit organik, për trajnime të ndyshme dhe pjesëmarrje në panaire online dhe jo vetëm.
- 9 mars 2021, AIDA dhe *EEN-Albania* zhvilluan webinarin me temë: "*E-commerce | Inovacion dhe zhvillim për bizneset*". Ky takim online pati si qëllim të informojë sipërmarrjet shqiptare mbi përdorimin e platformave novatore e-commerce, që ndihmojnë bizneset të jenë më konkurruese dhe të përmirësojnë procesin e të bërit biznes në treg.



- 20 prill 2021, AIDA dhe *EEN Albania*, organizuan webinarin me temë: Si të hartoni profilin e biznesit tuaj, hapi i parë drejt tregut europian. Ky *webinar* u mbajt për sipërmarrjet shqiptare me ambicie për të qenë pjesë e tregut europian me qëllim informimin mbi mënyrën se si hartohet një profil biznesi, si një hap i parë dhe i rëndësishëm për t'u bërë pjesë e tregut europian dhe për të zgjeruar aktivitetin në tregun ndërkombëtar.
- 7 dhjetor 2021, AIDA në bashkëpunim me Këshilla për Bizneset e Vogla (*ASB*), e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (*BERZH*), në kuadër të zbatimit të "Programit të Turizmit për Zhvillimin Ekonomik lokal", të financuar nga Bashkimi Evropian (*BE*), organizoi webinarin me temë: "Agroturizmi në Shqipëri: Model Biznesi për Zhvillimin Rural dhe Ruajtjen e Traditave Shqiptare". Gjatë *webinarit* pjesëmarrësit u njohën dhe diskutuan informacionet, si edhe praktikatat më të mira të aplikuara në sektorin e agroturizmit.

## 5.4 Panairi ndërkombëtar Expo 2020 Dubai

### 5.4.1 Shqipëria në Expo 2020 Dubai

Shqipëria ishte pjesë e panairit botëror *Expo 2020 Dubai*, me një pavijon të dedikuar me titull "*Albania a Timeless Trip*", së bashku me 192 shtete pjesëmarrëse, për një periudhë 6-mujore, nga 1 tetor 2021, deri më 31 mars 2022.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), kishte rolin e institucionit koordinues për organizimin e pavijonit të vendosur në zonën e Lëvizshmërisë "*Mobility*", një nga zonat kyçe të *Expo-s*. Pavijoni i Shqipërisë në *Expo 2020 Dubai*, kishte në fokus krijimin dhe prezantimin e urave lidhëse fizike dhe virtuale produktive për lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe ideve, duke siguruar qasje më të lehtë në tregje, njohuri dhe inovacion.

Një nga objektivat kryesorë ishte edhe promovimi i Shqipërisë si një partner i besuar tregtar dhe i investimeve të huaja në një sërë sektorësh të rëndësishëm për vendin si: energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia, etj.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në *Expo 2020 Dubai* kulmoi me Ditën Kombëtare më datë 9 mars,

ku Shqipëria ishte në qendër të organizimeve, gjatë se cilës u mbajtën performanca të ndryshme kulturore.

Ky panair shërbeu edhe si një mundësi e rëndësishme për promovimin e Shqipërisë si një destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, duke shpalosur bukuritë e vendit tonë, kulturën dhe traditën e pasur shqiptare.

Pavijoni i Shqipërisë në *Expo 2020 Dubai* ishte simbol i identitetit kombëtar, duke pasqyruar një Shqipëri me ngjyra, të re dhe dinamike.

Pavijoni i Shqipërisë u vizitua deri më 31 mars 2022, nga mbi 430 mijë vizitorë.

### 5.4.2 Ceremonia e Ditës Kombëtare të Shqipërisë në Expo 2020 Dubai

Më datë 9 mars 2022, u mbajt Dita Kombëtare e Shqipërisë në kuadër të pjesëmarrjes së vendit tonë në *Expo 2020 Dubai*. Kjo ditë e rëndësishme bëri bashkë vizitorë të pavijonit të Shqipërisë dhe miq e dashamirës të vendit tonë. Shqipëria ishte në qendër të organizimeve, ku gjatë gjithë ditës u mbajtën performanca të ndryshme kulturore.

Ditën Kombëtare e nderoi me pjesëmarrjen e tij Kryeministri i vendit, Z. Edi Rama dhe një pjesë e kabinetit qeveritar. Gjithashtu, Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, në rolin edhe të Komisarit të Përgjithshëm të Shqipërisë në *Expo 2020 Dubai*, e vlerësoi pjesëmarrjen në këtë event mbarëbotëror me rëndësi të veçantë në marrëdhëniet ekonomike dhe investimet që priten të jetësohen në vendin tonë.

### 5.4.3 Aktiviteti "Albanian Companies to Expo 2020 Dubai Opportunities"

AIDA, në rolin e institucionit koordinues të pavijonit shqiptar në panairin botëror *Expo 2020 Dubai*, si edhe në kuadër të shërbimeve të *EEN-Albania*, organizoi në datat 9-10 dhjetor 2021, aktivitetin e ndërmjetësimit për bizneset me temë "Albanian companies to EXPO 2020 Dubai opportunities", në Dubai.

Pjesëmarrës në aktivitet ishin përfaqësues të bizneseve shqiptare dhe të huaja, dhoma tregtie dhe organizata biznesi nga shtete

të ndryshme. Gjatë aktivitetit, përfaqësues të bizneseve shqiptare realizuan takime *B2B* me biznese ndërkombëtare pjesëmarrëse në *Expo 2020 Dubai*, me synim krijimin e kontratave të bashkëpunimit, shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencave, në një botë inovative në zhvillim të shpejt dhe të vazhdueshëm. Në vijim, bizneset shqiptare të shoqëruar nga stafi i AIDA-s zhvilluan vizita në pavijonet e disa shteteve pjesëmarrëse në *Expo 2020 Dubai* dhe patën mundësi të takojnë përfaqësues biznesi me qëllim evidentimin e partnerëve potencial ndërkombëtarë.

#### 5.4.4 Prezantimi i shqipërisë si një destinacion investimesh

AIDA, më datë 8 nëntor 2021, organizoi një event në qendrën Business Connect Center, në Dubai. Qëllimi i eventit ishte prezantimi i Shqipërisë si një destinacion investimesh dhe i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, si strukturë lehtësuese dhe promovuese e investimeve të huaja në Shqipëri.

Pjesëmarrësit shprehën interesin e tyre për të ditur më tepër mbi sektorët strategjikë në Shqipëri, si dhe asistencën që AIDA mund t'u ofrojë inves-

titorëve në realizimin e projekteve të tyre.

#### 5.4.5 Aktiviteti "Taste Albania" me delegacionin e bizneseve nga Shqipëria

AIDA, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCIT), në kuadër të Javës së Ushqimit, Bujqësisë dhe Jetesës, në Expo 2020 Dubai, organizuan në datë 26 Shkurt 2022, eventin "*Taste Albania*" në Dubai.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishte një delegacion biznesi i përbërë nga 19 kompani shqiptare, si edhe kompani të huaja, dhoma tregtie dhe organizata biznesi nga shtete të ndryshme.

Ky event bëri bashkë kompani prodhuese, eksportuese dhe tregtar të industrisë së ushqimit, duke dhënë mundësinë e krijimit të kontakteve të reja, me synimin e krijimit të kontratave të bashkëpunimit.

Gjithashtu, bizneset shqiptare të udhëhequr nga Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, në cilësinë edhe të Komisarit të Përgjithshëm të Pavijonit të Shqipërisë në *Expo 2020 Dubai*, zhvilluan vizita në pavijonet e disa shteteve pjesëmarrëse në *Expo 2020 Dubai*.

## 6 KOORDINIMI I AIDA-S

### 6.1. Hyrje

Drejtorja e Koordinimit mban dhe koordinon marrëdhëniet institucionale me institucione dhe organe brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me drejtoritë e tjera të AIDA-s. Gjithashtu, kjo drejtori koordinon edhe raportimet e ndryshme të institucionit si në kuadër të performancës, ashtu edhe të raportimeve që kanë të bëjnë me angazhime në marrëveshjeve apo nisma që Shqipëria është pjesë në nivel rajonal apo evropian.

### 6.2 Strategjia e Migracionit

Në kuadër të Strategjisë së Migracionit dhe

Planit të Veprimit 2019 - 2022, AIDA është institucion lider në një pikë të planit të miratuar me *VKM-në 400, datë 19.06.2019*. Në zbatim të strategjisë së migracionit janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Gjatë muajit janar është dërguar raportimi për Strategjinë e Migracionit për periudhën qershor – dhjetor 2020, ku është pasqyruar puna e AIDA-s, për realizimin e objektivit të percaktuar.
- Pjesëmarrje në *workshop-in (online)*: "Përmirësimi i Koordinimit të Qeverisjes së Migracionit në Shqipëri", organizuar nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migra-

- Migracionin (IOM).
- Pjesëmarrje në takimin (online), në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Migracionin. Në takim u diskutua për qartësimin dhe standartizimin e mënyrës së raportimit, si edhe problematikat apo sfidat e hasura gjatë përgatitjes së raporteve.
- Pjesëmarrje në trajnimin “Monitorimi dhe Vlerësimi i Politikave Publike”, organizuar nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me GIZ. Ky trajnim u organizua në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe efikasitetit të institucioneve për raportimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2019-2022.
- Raportim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në kuadër të raportit për Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe të Planit të Veprimit 2019–2022.
- Pjesëmarrje në takimin e parë të Komitetit Teknik për Migracionin. Ky komitet u ngrit në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Migracionin. Në takim u diskutua për raportet e progresit të përgatitura nga Sekretariati Teknik, ngritur në Ministrinë e Brendshme, gjithashtu u diskutua në lidhje me rishikimin afatmesëm të Planit të Veprimit të Strategjisë.
- Pjesëmarrje e stafit të drejtorisë së Koordinimit në trajnimin “Forcimi i kapaciteteve institucionale për qeverisjen e migracionit në Shqipëri”, organizuar nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me IOM dhe ASPA. Ky trajnim synonte përmirësimin e kapaciteteve të qeverisë shqiptare në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit (SKM), duke ofruar një pamje të qartë të saj dhe sfidave për zbatimin e kësaj strategjie, me qëllim që të përmirësohet qeverisja e migracionit në përfitim të të gjithë migrantëve e veçanërisht migrantëve në situatë vulnerabël.
- Raportim në Ministrinë e Brendshme, për përdhën Prill - Qershor, mbi Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019 - 2022.
- Sekretariati Teknik i Ministrisë së Brendshme ka dërguar Draft-Raportin Vjetor, mbi zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin, për periudhën Korrik 2020 - Qershor 2021.
- Pjesëmarrje në takimin e realizuar pranë Ministrisë së Brendshme, në vijim të punës për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migra-

cionin dhe për realizimin e një procesi rishikimi afatmesëm të Planit të Veprimit për Migracionin.

- Plotësim dhe dërgimi i pyetësorit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin, në kuadër të rishikimit të saj.
- Pjesëmarrje në takimin e dytë të Komitetit Teknik për Migracionin.

### 6.3 Kontributi në kuadër të BE-Shqipëri

AIDA është kontribuese gjithashtu në kuadër të përafrimit të legjislacionit me Acquis Communautaire të BE-së, kryesisht në Kapitullin Kriteri Ekonomik dhe Kapitullin 20 “Për politikat industriale”. Lidhur me këtë aspekt është marrë pjesë në disa takime, si dhe janë kryer një sërë raportimesh:

- Takimi online mbi përditësimet e Analizës së Mangësive Ligjore dhe Analizës së Mangësive Institucionale e Administrative (LGA + IAGA) për kapitullin 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”;
- Takim online i GNPIE Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”;
- Takim online me anëtarët e GNPIE kapitulli “ Kriteri Ekonomik”, ku u diskutua ecuria e deritanishme në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian si dhe sfidat për vitin 2021, riaktivizimi i Platformës së Integritetit Evropian, përditësimi i listës së anëtarëve të GNPIE kap.KE;
- Takimi online me antarët e GNPIE kapitulli “ Kriteri Ekonomik”, ku u diskutua mbi draft metodologjinë e dërguar nga projekti GIZ lidhur me Platformën e Bashkëpunimit për Integritetin Evropian. Vlerësimi i kandidatave të ardhura për PPIE, si dhe monitorimi i ecurisë së rekomandimeve të BE-së të dhëna në Nënkomitete dhe Raport-Progresin për vitin 2020;
- Dhënie kontribut për Kapitullin e “Kriterit Ekonomik”, në kuadër të Raportit të Komisionit Evropian 2021;
- Takim online me anëtarët e GNPIE për kapitullin 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale” në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integritetin Evropian;
- Pjesëmarrje e stafit të drejtorisë së Koordinimit në webinarin “Introduction to the legal

*history of the European Union*” i cili është zhvilluar në kuadër të kontibutit të GNPIE për raportimet e Kapitullit “Kriteri Ekonomik”;

- Pjesëmarrje në webinarin “*Legal Order of the European Union*” i cili është zhvilluar në kuadër të kontibutit të GNPIE për raportimet e Kapitullit “Kriteri Ekonomik”;
- Pjesëmarrje në webinarin “*Institutions and decision-making processes in the European Union*” i cili është zhvilluar në kuadër të kontibutit të GNPIE për raportimet e Kapitullin “Kriteri Ekonomik”;
- Takim online me anëtarët e GNPIE Kapitulli “Kriteri Ekonomik”, ku u diskutua mbi monitorimin e ecurisë së rekomandimeve të BE-së dhe përgatitjen për hartimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian PKIE 2022-24;
- Është ndarë informacioni me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të përgatitjes së raportit “*Trade Review*”, për periudhën maj - tetor 2021, për politikën tregtare të vendeve lidhur me të gjitha masat tregtare dhe të lidhura me tregtinë, si dhe masat e marra posaçërisht në kontekstin e pandemisë COVID-19;
- Dhënie kontributi për Kapitullin “Kriteri Ekonomik”, në kuadër të Raportit të Komisionit Evropian 2021.
- Dhënie kontributi për Kapitullin “Kriteri

Ekonomik”, në kuadër të hartimit të Planit të ri Kombëtar për Integritimin Evropian (PKIE 2022-24).

- Pjesëmarrje në Webinarin “*Preparation of the National Plan for European Integration 2022 – 2024*”.
- Dhënie kontributi për kapitullin 20 “Ndërmarrjet dhe Politikën Industriale” dhe kapitullin “Kriteri ekonomik”, në kuadër të kërkesave të zyrës së Kryenegociatorit lidhur me raportimin për përditësimin e statusit të ecurisë së përmbushjes së rekomandimeve të BE-së të dhëna në Progres Raportin e KE për Shqipërinë për vitin 2021.
- Është dhënë kontribut për kapitullin 20 “Ndërmarrjet dhe Politikën Industriale” për pjesën narrative të PKIE 2022-2024.

#### 6.4 Bashkëpunime Institucionale

Në kuadër të takimeve dhe aktiviteteve të ndryshme të zhvilluara nga MFE, AIDA ka kontribuar në dërgimin e informacioneve të përditësuara për sa i takon bashkëpunimit ekonomik me shtete të ndryshme në lidhje me fluksin dhe stokun në vendin tonë.

## 7 AIDA NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RITJES SË IMAZHIT NDËRINSTITUCIONAL

### 7.1. Programi i transparencës

Si një institucion i pavarur publik AIDA funksionon në përputhje me standardin e transparencës, duke siguruar, gjatë veprimtarisë së vet, zbatimin rigoroz të detyrimeve që rrjedhin prej ligjit 119/2014, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. AIDA në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 119 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, ka kryer Rishikimin e Programit të Transparencës, të miratuar me urdhrin nr. 06 datë 01.04.2021, duke e përditësuar me ndryshimet e nevojshme. Në përgatitjen e rishikimit të programit të trans-

parencës është mbajtur parasysh interesi më i lartë i publikut, me qëllim pakësimin e nevojave për kërkesa individuale për informacion me qëllim:

- Garantimin e njohjes maksimale me informacion;
- Vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- Modelet e miratuara për kategoritë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Dre-

jtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në Programin e Transparencës janë të specifikuar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të institucionit. Gjithashtu, përpara publikimit të informacionit AP duhet të vlerësojë nëse ka ndonjë kufizim ligjor për publikim.

Në programin e transparencës janë të specifikuar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik, mënyra e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej të cilave lind detyrimi për publikim. Në publikimin e informacionit, AP duhet të mbajë parasysh interesin e publikut, si dhe të mundësojë aksesimin lehtësisht në informacionin publik.

Në shërbim të publikut dhe përmirësimit të procedurave administrative, pjesë e transparencës janë dhe formularët digjitalë për ankesa/aplikime, duke mundësuar thjeshtimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut.

Kërkesat për informacion që kanë ardhur pranë AIDA-s, për vitin raportues gjenden të pasqyruara edhe në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, në faqen zyrtare të autoritetit. Ato i referohen anëtarëve të Komitetit të Investimeve Strategjike, numrit dhe listës së projekteve strategjike të miratuar, rasteve kur është trajtuar shpronësimi i pasurisë private dhe kontratat e miratuara nga Kuvendi në funksion të një investimi strategjik, por edhe politikave të institucionit në lidhje me nxitjen investimeve nga diaspora shqiptare në vendlindjen e tyre.

AIDA bën monitorimin paraprak dhe konstatues në baza ditore, të përmbajtjes së çdo e-maili të ardhur në adresën zyrtare të agjencisë *info@aida.gov.al*. Për vitin 2021, në adresën *info@aida.gov.al* kanë ardhur 645 e-maile për kërkesë informacioni, të cilat pasi janë shqyrtuar dhe hartuar informacioni i nevojshëm ju është dërguar kthim-përgjigjja brenda afateve të përcaktuara të rregullores. Për të gjitha eventet dhe aktivitetet që AIDA ka organizuar ose ka marrë pjesë,

janë informuar me e-maile sipërmarrjet shqiptare sipas databazës së disponueshme.

## 7.2 Menaxhimi i burimeve njerëzore

Duke konsideruar menaxhimin e burimeve njerëzore si një prej elementëve thelbësorë për krijimin e një administrate profesionale, të qëndrueshme, efektive dhe të përgjegjshme, AIDA ka synuar përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrative me standardet dhe praktikatat me të mira në vend.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është struktura mbështetëse e funksionimit të AIDA-s, në realizimin e misionit të saj. Drejtimi i burimeve njerëzore në AIDA realizohet në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të saj.

Në planin afatshkurtër vëmendja e burimeve njerëzore u përqëndrua në rekrutimin e punonjësve gjithnjë e më cilësor, trajnimin e mëtejshëm e sa më të plotë të punonjësve, nxitjen dhe motivimin e tyre, si dhe në vlerësimin e performancës përgjatë vitit.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është angazhuar dhe ka ndjekur në vijimësi procedurat e rekrutimit të punonjësve për vendet vakante, me qëllim realizimin e këtij procesi duke ju përmbajtur përcaktimeve ligjore, kriterëve dhe specifikave për secilin pozicion vakant, në zbatim të ligjit nr. Ligjin 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe referuar nismës "Gati për Shqipërinë", për vitin 2021.

Për punonjësit janë ndjekur procedurat e emërimeve në detyrë, lirime nga detyra, si dhe emërimet afatgjata e të përkohshme në detyrë kundrejt kontratave të lidhura me personat e emëruar. Konkretisht, janë realizuar 2 emërimet të reja për vitin 2021, 1 Specialist, dhe 1 Drejtor Drejtorie.

Vënde vakant për institucionin janë aktualisht 6 pozicione: 1 Drejtor Drejtorie, 4 specialist, 1 Shofer.

### 7.2.1 Zhvillimi i burimeve njerëzore

Përgjatë vitit 2021, lidhur me zhvillimin e burimeve njerëzore, janë realizuar:



1. Përgatitja e manualit të burimeve njerëzore mbi menaxhimin e kohës së punës, pushimit dhe etikën në punë;
2. Përditësimi i dosjeve të punonjësve në sistemin e HRMIS;
3. hedhja e të dhënave të përditësuara për Punonjësit ekzistues dhe të rinj;
4. Plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi.

### 7.2.2 Rritja e kapaciteteve të punonjësve

Në kuadër të evidentimit të nevojave për zhvillimin profesional të punonjësve mbi vlerësimin institucional dhe zhvillimin e kapaciteteve, si një ndër funksionet kryesore të burimeve njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, realizoi procesin e Vlerësimit të Nevojave për Trajnim për periudhën 2021-2022, për të gjithë punonjësit, me qëllim evidentimin e nevojave për trajnim dhe përmbushjen e tyre, për rritjen e aftësive dhe efikasitetit në punë, në përmbushje të objektivave dhe prioriteteve të Agjencisë.

Ky proces synoi vlerësimin dhe evidentimin e nevojave për trajnim në disa fusha kryesore si: Kodi i Procedurave Administrative, Teknologjia dhe Inovacioni, Menaxhimi dhe Eficienca, Integrimi Europian, Hartim legjislativ, si dhe çështje të tjera që lidhen me detyrat funksionale të punonjësve.

Në këtë proces morën pjesë 22 punonjës (kategori e mesme drejtuese, e ulët drejtuese dhe ekzekutive).

Temat përkatëse për zhvillimin dhe bashkëpunimin me programe të mbështetjes së NMVM-ve shqiptare, si dhe mbi politikën e Investimeve të Huaja Direkte, si vijon:

- Ministria e Brendshme në bashkëpunim me GIZ - Programi Global "Migrimi dhe Diaspora" financuar nga Qeveria Gjermane, organizuan trajnimin "Monitorimi dhe Vlerësimi i Politikave Publike", me pjesëmarrës, staf nga Drejtoria e Koordinimit.
- ITC/DIE Project on Investment Facilitation for Development, International Trade Centre, organizuan trajnim me temë "*Investment facilitation: promoting linkages and supplier databases*", me pjesëmarrës, staf nga Drejtoria e Investimeve.
- *Workshop* virtual organizuar nga EXBS (US Ex-

port Control and Related Border Security Office), në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, me temë "Adresimi i rreziqeve për sigurinë kombëtare në transaksionet ndërkombëtare".

- *Linking outward FDI to inward FDI: The role of home country measures 4 May 2021*, organizuar nga International Trade Center (ITC);
- *Digital Economy in Albania*, organizuar nga Risi Albania dhe Sekretari i Këshillit të Investimeve.
- *Getting stronger after COVID-19 Nearshoring potentials in the Western Balkans*, organizuar nga Chamber Investment Forum Western Balkans 6.
- *Business Talk*, organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqiptare (CCIS).
- Trajnimi mbi *Business Climate Survey 2021*, me temë: "*Presentation of the results*", organizuar nga Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA), në datën 8 qershor 2021, pjesëmarrës nga Sektori i Investimeve dhe *AfterCare*.
- Trajnimi mbi *Business Climate Survey 2021* – me temë: "*Presentation of the results*", organizuar nga Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA), në datën 8 qershor 2021, pjesëmarrës nga Sektori i Investimeve dhe *AfterCare*.
- *Webinar on E-commerce of SMEs and Start-ups Enterprises for Albania*, organizuar nga China Centre for Promotion of SME Development.
- *OECD SEE Competitiveness Outlook 2021: Launch meeting for Albania* – Sektori FDI.
- Parregullsitë që hasen në projektet dhe programet e financuara nga BE Confirmation, organizuar nga ASPA.

### 7.2.3 Specifikat e punës në kushtet e COVID-19

Gjatë vitit 2021, kanë vazhduar të mbeten në fuqi dhe të zbatueshme masat kundër infeksionit Covid-19. Punonjësit e infektuar, kanë qëndruar në banesë deri në shërimin e tyre të plotë. Gjithashtu, sipas nevojës janë kryer disa teste për punonjësit e të gjitha drejtorive duke fikuar kështu rastet pozitive ose të dyshuara me Covid-19. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka marrë të gjitha masat dhe ka kryer dezinfektimin e ambienteve për të siguruar një ambient pune sa më të sigurt.

### 7.3 Hartimi i Regjistrimit të Prokurimeve Publike

Komisioni për Blerjen me Vlerë të Vogël ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 1 prot., datë 05.01.2021, hartoi dhe hodhi në sistem për miratim nga Agjencia për Prokurimin Publik "Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve për Vitin 2021". Elementët e këtij regjistri u hartuan bazuar në nevojat e institucionit, sipas shpenzimeve të kryera gjatë vitit 2020.

Me ndryshimet e bëra gjatë vitit 2021 në legjislacionin e Prokurimit Publik, lindi nevoja e ndjekjes së trajnimeve të ndryshme të organizuara në kuadër të informimit të Autoritetve Kontraktore. Komisioni ka ndjekur trajnimin e organizuar nga Komisioni i Prokurimit Publik me temë "Sistemi i ri i shqyrtimit të ankesave" dhe ka zbatuar të gjitha njohuritë e marra në procedurat e zhvilluara.

#### 7.3.1 Blerje dhe lidhje kontratash të ndryshme në zbatim të legjislacionit në fuqi

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, gjatë vitit 2021, ka realizuar procedurat e Prokurimeve me Vlerë të Vogël dhe Blerjet me Sistem Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar, në përputhje me nevojat e institucionit. Këto procedura janë realizuar në kohë, mbështetur në aktivitetet e parashikuara nga drejtoritë e tjera, si dhe duke ju përmbajtur përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

### 7.4 Treguesit financiar

AIDA, në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligjet organike, mbi të cilat ushtron veprimtarinë e tij. Gjithashtu, ka krijuar dhe monitoruar një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në legjislacionin në fuqi konform dispozitave të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Mbi menaxhimin financiar e kontrollin", si dhe mbi parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitet, transparencë, ekonomi dhe efikasitet.

#### 7.4.1 Menaxhimi i burimeve financiare

Për të realizuar një menaxhim financiar efikas për vitin 2021, janë ndërmarrë hapa konkrete në përshtatje me ndryshimin e kushteve përgjatë vitit. Më konkretisht:

- Detajimi i shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale për vitin 2021, mbi bazën e fondeve të alokuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në artikujt për paga, sigurime shoqërore, shpenzime për mallra e shërbime, transferime në buxhete familjare si dhe investime, sipas projekteve të miratuara në nivel mujor dhe vjetor;
- Rishikimi i planeve të detajuara në muaj për shpenzimet operative dhe investime për vitin 2021, si dhe rishpërndarja e tyre në muajt pasardhës në zbatim të Udhëzimit të përherëshëm "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe duke respektuar përqindjet e vendosura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Përgatitja, rakordimi i llogarive vjetore si dhe plotësimi i pasqyrave financiare me anekset përkatëse mbi gjendjen e aseteve fikse e qarulluese dhe gjendjen financiare në fund të vitit 2021, në zbatim të ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, brenda afateve kohore të përcaktuara në to;
- Planifikimi, përgatitja dhe dërgimi pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të kërkesave buxhetore të detajuara, të Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2022-2024, në zbatim të Udhëzimit "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024", si dhe të Udhëzimit "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm", me anekset e tyre përkatëse, gjatë të dy fazave, prill dhe gusht 2021. Sipas udhëzimeve për hartimin e PBA 2022-2024, hapave dhe procedurave të miratuara në to, janë planifikuar nevojat për mbështetje financiare, në funksion të përmbushjes së misionit të AIDA-s, për realizimin e objektivave të matshëm afatshkurtëra dhe afatmesme;
- Përcaktimi i personave përgjegjës, të cilët kanë përgjegjësinë mbi menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare dhe jofinanciare në mbështetje të arritjes së objektivave, politikës dhe qëllimeve të institucionit, në zbatim të ligjit të mësipërm;
- Përcjellje informacioni pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi pakësimet e fondeve;
- Rakordim me Degën e Thesarit Tiranë për periudhën janar – dhjetor 2021;
- Blerje dhe lidhje kontratash të ndryshme, në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Ndarja e buxhetit sipas tabelës së detajimit

përcjellë nga MFE për projektet me financim të huaj (EEN dhe FILA) dhe koordinimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Raiffeisen Bank për debitimin e shumës së financimit në llogarinë e AIDA-s;

- Rakordimi i gjendjes së arkës, karburantit, magazinës dhe aktiveve të AIDA-s.


#### 7.4.2 Zbatimi i buxhetit

- Hartimi dhe detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente 600, 601, 602 dhe 606, në funksion të përmbushjes së objektivave të AIDA-s. Ky buxhet është detajuar në fillim të vitit dhe është rishikuar gjatë vitit, për shkak të pjesëmarrjes në Expo 2020 Dubai.
- Gjatë vitit 2021, me ndryshimet e bëra në buxhet, në përshtatje të kushteve të reja, u realizuan shpenzimet korrente dhe kapitale, siç paraqiten në grafikun e mëposhtëm.
- Fondi për paga dhe sigurime u realizua përkatësisht në masën 79% dhe 71%. Për sa i përket shpenzimeve korrente, ato u realizuan në masën 95%. Shpenzimet për transferta individësh u realizuan në masën 98% dhe shpenzimet për TVSH që lidhen me projektin EEN u realizuan në masën 3%. Ndërsa fondi i investimeve kapitale të brendshme u realizua

në masën 46%.

- Janë përmbyllur dhe rakorduar me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit "Pasqyra Financiare e vitit 2020 dhe shpenzimet e realizuara sipas muajve.";
- Hartimi i PBA-së 2022-2024, në përputhje me nevojat e institucionit sipas hapave dhe procedurave të miratuara, në to janë planifikuar nevojat për mbështetje financiare, në funksion të përmbushjes së misionit të AIDA-s, për realizimin e objektivave afatshkurtra e afatmesme, mbi baza produktesh. Ky proces është realizuar sipas legjislacionit në fuqi në dy fazat e tij, gjatë muajit prill dhe gusht 2021.
- Plotësimi i nevojave institucionale të shërbimeve dhe mallrave, nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit publik, duke plotësuar nevojat e përgjithshme, por gjithashtu duke plotësuar nevojat për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Expo 2020 Dubai.
- Ruajtja dhe administrimi i aseteve (pasurisë) së AIDA-s, duke vlerësuar dhe zhvlerësuar sipas ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Realizimi i Buxhetit 2021



## 8 Objektivat e AIDAs për vitin 2022

### 8.1 Objektiva në kuadër të Investimeve të Huaja Direkte dhe Investimeve Strategjike në Shqipëri

- Rishikimi i target grup dhe përgatitja e një strategjie promovimi investimesh koherente;
- Implementimi i sistemit CRM (Customer relationship management);
- Zhvillimi i fushatave outreach;
- Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të synuara;
- Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme (Aftercare);
- Identifikimi i zonave shtetërore/private për t'ua propozuar investitorëve në kushtet kur kërkojnë sipërfaqe toke/fabrika për të investuar;
- Ndjekje e zbatimit të projekteve strategjike.

### 8.2 Objektiva në kuadër të zhvillimit të Ndërmarrjeve të Mesme, të Vogla dhe Mikro

- Rritja e aksesit në financë për NMVM-të (BIDS 2021-2027);
- Ndjekja e strategjisë së eksporteve (BIDS 2021-2027);
- Përgatitja e skemës për mbështetjen e sipërmarrjes me bazë konkurrencën (BIDS 2021-2027);
- Vlerësimi periodik i nevojave për trajnim (BIDS 2021-2027);
- Kontribut në hartimin dhe zbatim e politikave/strategjive të Qeverisë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme;
- Nxitja e aftësive konkurruese dhe sipërmarrëse të NMVM-ve shqiptare, në kuadër të inovacionit dhe progresit teknologjik (BIDS 2021-2027);
- Zbatimi i programit strategjik për zhvillimin e inovacionit dhe teknologjisë të NMVM-ve për periudhën 2017-2022;
- Zhvillimi i biznesit elektronik ( e-commerce) (BIDS 2021-2027).

### 8.3 Objektiva në kuadër të promovimit të institucionit

- Mirëmbajtja e komunikimit publik: website, rrjete sociale, institucionet partnere, grupet e interesit;
- Përgatitje e materialeve informuese dhe promovuese për investimet në Shqipëri;
- Përgatitje e materialeve informuese dhe promovuese për zhvillimin e NMVM-ve në Shqipëri;
- Promovimi i Skemave të Financimit të AIDA-s;
- Identifikimi dhe promovimi i të dhënave të nevojshme për bizneset, publikime studime, kërkime dhe analiza tregtare;
- Mbështetja e Drejtorisë së NVM-ve dhe Projekteve për programet në ndihmë të biznesit;
- Mbështetja e Drejtorisë së Investimeve për tërheqjen e investimeve dhe ndërkombëtarizimit nëpërmjet marketingut;
- Përfaqësimi i Shqipërisë në panairin Expo 2020 Dubai.

### 8.4 Objektiva në kuadër të përmbushjes së transparencës dhe rritjes së imazhit ndërinstitucional

- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për plotësimin e strukturës me të gjithë punonjësit;
- Finalizimi i dorëzimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të arkivave i dokumentacionit arkivor për vitin 2011;
- Hartimi i projekt-buxhetit dhe programi buxhetor afatmesëm, sipas udhëzimeve në fuqi të nxjerra nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë;
- Hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2021;
- Parashikimi dhe kostimi i aktiviteteve të programuara për vitin 2022;
- Ndarja e shpenzimeve korente në bazë të prioritetëve dhe fianacimeve duke i dhënë prioritet projekteve strategjike;
- Mbështetja e vazhdueshme për përmbushjen e parashikimeve të AIDA;
- Mbështetje me kapacitete njerëzore për realizimin e aktiviteteve;
- Rritja e kapaciteteve të punonjësve të AIDA.

# ANEKS 1

## PROJEKTE KONKRETE TË TRAJTUARA ME LIGJIN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

| Nr.                   | Subjekti Aplikues/<br>Emri i Projektit | Sektori              | Vlera/<br>Punësimi                    | Afati i realizimit                                             | Përshkrimi                                                                                    | Vendndodhja                        | Pronësia | Procedura                                                      | Status Aktual                                                                                                        |
|-----------------------|----------------------------------------|----------------------|---------------------------------------|----------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|----------|----------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| PROJEKTE TË MIRATUARA |                                        |                      |                                       |                                                                |                                                                                               |                                    |          |                                                                |                                                                                                                      |
| 1                     | MANE TCI<br>"New Born"                 | Turizëm              | €<br>26,000,000<br><br>250 vende pune | 13.03.2020                                                     | Kompleks turistik në<br>S=187,000 m2.                                                         | Hamallaj,<br>Durrës                | Privat   | Procedurë e Asistuar me vendim të KIS Nr. 1/15 datë 14.7.2016. | Është realizuar afërsisht 95% e investimit.                                                                          |
| 2                     | GREEN COAST<br>"Green Coast 1"         | Turizëm              | €<br>52,500,000<br><br>250 vende pune | 27.04.2021                                                     | Kompleks turistik në<br>S=183,500 m2.                                                         | Palasë, Himarë                     | Privat   | Procedurë e Veçantë me vendim të KIS Nr. 2/13 datë 14.7.2016.  | Është realizuar mbi 50% e investimit.                                                                                |
| 3                     | ALB PANEL<br>NGR<br>"Albpanel"         | Bujqësi Industrial e | €<br>15,000,000<br><br>300 vende pune | 38 muaj nga data e fillimit pasi investimi nuk ka filluar ende | Projekti synon të përdorë lëndë të parë kallamin dhe të prodhojë si produkt final panele MDE. | Libofshe, Fier dhe Rremas, Lushnjë | Shtet    | Procedurë e Asistuar me vendim të KIS Nr. 7/1, datë 5.12.2016. | Janar 2020, KIS miratoi një ndryshim në vendimin për Albpanel për ndryshim zone. Vendim KIS NR. 7/5 , datë 7.1.2020. |



|   |                                         |         |                                      |            |                                |                                        |                                              |                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                        |
|---|-----------------------------------------|---------|--------------------------------------|------------|--------------------------------|----------------------------------------|----------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 4 | AGROCON<br>ALBANIA<br>"Agrocon"         | Bujqësi | € 5,832,000<br>120 vende<br>pune     | 26.01.2019 | Ferme Bujqësore në<br>S=30 Ha. | Ngurrëz e<br>Vogël, Krutje,<br>Lushnjë | Shtet                                        | Procedurë e<br>Asistuar me<br>vendim të KIS<br>Nr. 21/2, datë<br>20.12.2017.                                                                                                                    | Është realizuar afërsisht<br>95% e investimit.                                                                                                                         |
| 5 | CONCORD<br>INVESTMENT<br>"Gone Perivol" | Turizëm | €<br>32,500,000<br>200 vende<br>pune | 12.04.2022 | Kompleks Turistik              | Palasë, Himarë                         | Privat                                       | Procedurë e<br>Asistuar<br>miratuar me<br>vendim të KIS<br>nr. 24/2, datë<br>20.11.2017.<br><br>Shtyrë afati i<br>vlefshmërisë së<br>statusit me<br>vendim të KIS<br>nr. 24/7 datë<br>29.3.2021 | Është realizuar afërsisht<br>20% e investimit.                                                                                                                         |
| 6 | CONCORD<br>INVESTMENT<br>"San Pietro"   | Turizëm | €<br>88,000,000<br>250 vende<br>pune | 05.05.2020 | Kompleks Turistik              | Gjiri i Lalzit                         | Privat                                       | Procedurë e<br>Veçantë,<br>miratuar me<br>vendim të KIS<br>Nr.25/2, datë<br>20.12.2017.                                                                                                         | Është realizuar afërsisht<br>60% e investimit.<br><br>Me vendim të KIS<br>dhjetor 2020, është bërë<br>shtyrja e afatit të Statusit<br>për një periudhë 2 -<br>vjeçare. |
| 7 | BOIKEN SHPK<br>"Kepi Merli"             | Turizëm | €<br>78,000,000<br>263 vende<br>pune |            | Eko Resort                     | Ksamil,<br>Sarandë                     | Shtet<br>(Subjekti<br>person i<br>stimuluar) | Subjekti aplikoi<br>për Procedurë<br>të Veçantë. Me<br>vendim të KIS<br>me Nr. 27/2,<br>datë<br>20.12.2017, u<br>vendos një afat                                                                | Projekti në proces                                                                                                                                                     |

|   |                        |         |                                          |  |                   |               |        |                                                                                                                                                                |                                         |
|---|------------------------|---------|------------------------------------------|--|-------------------|---------------|--------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|
|   |                        |         |                                          |  |                   |               |        | 30 ditë pune<br>shitesë për<br>shqyrtim të<br>mëtejshëm nga<br>MTM. Miratuar<br>me vendim të<br>KIS Nr. 27/5<br>datë<br>04.03.2019.                            | zbatimi.                                |
| 8 | XH&M CO<br>"Delta Bay" | Turizëm | €<br>22,700,000<br><br>107 vende<br>pune |  | Kompleks Turistik | Palasë, Vlorë | Privat | Subjekti ka<br>aplikuar për<br>Procedurë të<br>Asistuar. Me<br>vendim të KIS<br>Nr. 23/2, datë<br>20.11.2017, u<br>vendos që<br>duhet pritur<br>vendimi i KKT. | Subjekti nuk ka riaplikuar<br>tek AIDA. |

|    |                          |                     |                                           |                                           |                      |                         |        |                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                       |
|----|--------------------------|---------------------|-------------------------------------------|-------------------------------------------|----------------------|-------------------------|--------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|
| 9  | STAR TEK<br>"Dhërmi"     | Turizëm             | €<br>12,140,000<br><br>300 vende<br>pune  |                                           | Resort Turistik      | Dhërmi                  | Shtet  | Subjekti aplikoi për Procedurë të Asistuar. Me vendim të KIS Nr. 28/2, datë 20.12.2017, u dha një afat shtesë prej 30 ditë pune për të plotësuar projektin me dokumentacion shtesë nga ana e subjektit. Miratuar me vendim të KIS Nr. 2/3 datë 02.09.2019. | Projekti fillon zbatimin pasi të behet regjistrimi fillestar i zonës. |
| 10 | GPP KORÇA                | Energji (TEC Korça) | €<br>349,700,000<br><br>123 vende<br>pune | 3 vite nga data e fillimit te investimit. | HEC Korça            | Korçë                   | Shtet  | Procedurë e Veçantë, miratuar me vendim të KIS Nr.30/4, datë 14.02.2018.                                                                                                                                                                                   | Subjektit i është refuzuar Deklarata Mjedisore nga MTM.               |
| 11 | EUROCOL<br>"White Rocks" | Turizëm             | € 6,800,000<br><br>81 vende<br>pune       | 3 vite nga fillimi                        | Resort Turistik      | Dhërmi,<br>sip. 1.91 Ha | Privat | Procedurë e Asistuar, miratuar me vendim të KIS Nr.15/3, datë 04.03.2019.                                                                                                                                                                                  | Projekti në proces zbatimi                                            |
| 12 | AQUATIO<br>"Akuaponi –   | Bujqësi             | € 5,1 mln<br><br>50 vende                 | 6 muaj nga data e fillimit te             | Akuaponi – hidroponi | Karavasta,<br>Divjake   | Shtet  | Procedurë e Asistuar, miratuar me                                                                                                                                                                                                                          | Subjektit ka riaplikuar për një sipërfaqe më të madhe, në të njëjtën  |

|    |                                                                     |                                                                   |                                       |                                                                                             |                                                   |                                     |                     |                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----|---------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-------------------------------------|---------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    | hidropo                                                             |                                                                   | pune                                  | investimit                                                                                  |                                                   | 1,3 ha<br>Kërkon 146 ha             |                     | vendim të KIS<br>Nr.4/4, datë<br>19.04.2018.                                                  | zonë ku është miratuar<br>edhe ndryshimi<br>potencial për Albpanel                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 13 | GROILIRIA<br>"Planatacion<br>shege,<br>avokado,<br>finger lime...." | Bujqësi                                                           | € 6,627 mln<br><br>115 vende<br>pune  | 5 vite nga<br>data e<br>fillimit.<br><br>Investimi ka<br>filluar<br>vetëm në<br>87 ha tokë. | Planatacion shege,<br>avokado, finger<br>lime.... | Karavasta,<br>Divjakë<br><br>500 ha | Shtet               | Procedurë e<br>Asistuar.<br><br>Miratuar me<br>vendim të KIS<br>Nr. .6/4, datë<br>19.04.2018. | Në proces nënshkrimi i<br>MGF ndërmjet MFE dhe<br>subjektit.<br><br>Ndryshim vendimi, me<br>vendimin e KIS Nr. 6/9,<br>datë 24.06.2020, me të<br>cilin u miratua<br>zëvendësimi i kulturave<br>me kivi, rrush, dardhë<br>etj., si dhe zhvillimi i<br>agroturizimit, në zonën e<br>Karavastasë,<br>Bashkia Divjakë. |
| 14 | YURA<br>COPERATION<br>ALBANIA                                       | Industri<br>Automoti<br>ve (Zonë<br>me<br>përparësi<br>zhvillimi) | € 6.459.000                           | 2 vite                                                                                      | Fabrike për<br>prodhimin e pjesëve<br>automotive  | Bazo e Tubove<br>Fier               | Shtet               | Procedure e<br>Asistuar.<br><br>Miratuar me<br>vendim të KIS<br>Nr 14/3 datë<br>12.02.2019.   | Projekti në proces<br>zbatimi                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| 15 | SOLEIL & SEA<br>"Jala<br>Entertainment<br>Park"                     | Turizëm<br>(Komplek<br>s Turistik)                                | € 67,000,000<br><br>620 vende<br>pune | 3 vite                                                                                      | Resort Turistik                                   | Jale – Vuno,<br>Himarë              | Privat dhe<br>Shtet | Miratuar me<br>vendim të KIS<br>Nr. 20/5, datë<br>01/08/2019.                                 | Projekti në proces<br>zbatimi. Është pezulluar<br>një pjesë e projektit për<br>shkak të çështjeve të<br>pronësisë.                                                                                                                                                                                                 |

|    |                                           |                                                      |                                             |                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                 |                     |                                                                                     |                                |
|----|-------------------------------------------|------------------------------------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|---------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|
| 16 | BASHKIA<br>TIRANË<br><br>"TEDA<br>TIRANË" | Zonë e<br>Teknologjisë dhe<br>Zhvillimit<br>Ekonomik | €<br>102,666,431                            | Brenda 1<br>viti nga<br>vendimi i<br>KIS Bashkia<br>duhet të<br>aplikojë për<br>marrjen e<br>statusit final<br>strategjik | Realizimi i një Zone<br>të Teknologjisë dhe<br>Zhvillimit Ekonomik<br>me qëllim tërheqjen<br>e investimeve të<br>huaja dhe<br>teknologjive të reja<br>dhe teknologjive të<br>informacionit,<br>hapjen e vendeve të<br>reja të punës,<br>nxitjen e zhvillimit<br>ekonomik të qytetit<br>të Tiranës duke futur<br>industri që<br>përmbushin<br>standarde<br>ndërkombëtare me<br>produktivitet të<br>lartë. | Në<br>në zonën<br>Yzberisht,<br>Gropaj dhe<br>Kashar,<br>Tiranë | Privat dhe<br>Shtet | Miraturar me<br>vendim të KIS<br>Nr. 1/4, datë<br>04.05.2020.                       | Projekti në proces<br>zbatimi. |
|    |                                           |                                                      | € 62,000,000<br><br>5000-7000<br>vende pune | 4 vjet                                                                                                                    | Realizimi i një Zone<br>të Teknologjisë dhe<br>Zhvillimit Ekonomik<br>me qëllim tërheqjen<br>e investimeve të<br>huaja dhe<br>teknologjive të reja<br>dhe teknologjive të<br>informacionit,<br>hapjen e vendeve të<br>reja të punës,<br>nxitjen e zhvillimit<br>ekonomik të qytetit<br>të Tiranës duke futur<br>industri që                                                                              | Në<br>në zonën<br>Yzberisht,<br>Gropaj dhe<br>Kashar,<br>Tiranë | Privat dhe<br>shtet | Miraturar statusi<br>përfundimtar<br>me vendim të<br>KIS Nr. 1/8 datë<br>15.7.2021. |                                |



|    |                                                                               |         |                                 |                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                        |                  |                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|----|-------------------------------------------------------------------------------|---------|---------------------------------|-----------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                                                                               |         |                                 |                 | përbushin standarde ndërkombëtare me produktivitet të lartë.                                                                                                                                                                                                                                           |                                        |                  |                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 17 | LAJTHIZA INVEST SH.A<br>"Kompleks Turizëm Rural Lajthiza"                     | Turizëm | € 20,000,000<br>200 vende pune  | Dhjetor 2022    | Hotel modern, si dhe një fabrikë të re të ambalazhimit të ujit të pijshëm në shishe.                                                                                                                                                                                                                   | Fshati Lajthizë, Bashkia Fushë – Arrëz | Shtet            | Miraturar me vendim të KIS Nr. 36/6, datë 24.06.2020.                                              | Projekti është në proces.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 18 | SHIDDI GROUP SH.P.K DHE AL SHIDDI TRADING COMPANY LTD<br>"TIRANA CITY CENTER" | Turizëm | 106,850,000<br>1500 vende pune  | Brenda 6 viteve | Ndërtimi i një investimi kompleks dhe i përket pjesërisht sektorit strategjik të turizmit me strukturë akomoduese elitare turistike-hotel, apartamente elitare hotel, vila elitare Sky Village, strukturë mbështetëse turistike-qendër tregtare dhe garazh nëntokësor ashtu, si dhe ndërtesë për zyra. | Tiranë                                 | Shtet            | Miraturar me vendim të KIS Nr. 2/7, datë 27/07/2020.<br><br>Vendim të KIS Nr. 2/10, datë 4.2.2021. | Duke u vlerësuar përbushja nga subjekti investues i kriterit financiar duke dëshmuar disponimin e kapacitetit financiar në vlerën prej 20% të vlerës totale të investimit si dhe plotësimin e kushteve paraprake.<br><br>Parakushtet e vendosura me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.2/7, datë 27.07.2020, konsiderohen të plotësuar nga ana e subjektit. |
| 19 | GREEN COAST SHPK<br>Green Coast                                               | Turizëm | € 125,400,000<br>800 vende pune | 36 muaj         | Ndërtimi i 2 (dy) strukturave akomoduese turistike, hotel 5 yje, si dhe kompleks                                                                                                                                                                                                                       | Palasë, Himarë                         | Privat dhe shtet | Vendim i KIS dhjetor 2020.                                                                         | Projekt ka përfutur status strategjik me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.2/13, datë                                                                                                                                                                                                                                                                       |

|    |                                                       |         |                                        |         |                                                                                                                                                                                                                                                                        |               |       |                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|----|-------------------------------------------------------|---------|----------------------------------------|---------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|-------|---------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                                                       |         |                                        |         | turistik.                                                                                                                                                                                                                                                              |               |       |                                       | 14/07/2016, me afat 4 (katër) vjeçar. Subjekti është pajisur me Leje Zhvillimore Komplekse Nr. Prot 2385/2, datë 27.04.2015, lëshuar sipas Vendimit Nr.8, datë 07.03.2014, miratuar nga KKT, e përditësuar me Lejen e Ndërtimit sipas Vendimit Nr.13. datë 12.04.2017, për "Rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese dhe shtesë në sipërfaqe të Resortit Turistik "Green Coast", me adresë në Palasë, Bashkia Himarë", miratuar nga KKT. |
| 20 | POWER GREEN ENERGY SH.P.K.<br><br>MARSEGLIA GROUP SRL | Energji | €<br>244,000,000<br><br>350 vende pune | 18 muaj | Ndërtimi i dy parqeve me erë, të quajtura BPGE1 dhe BPGE2, në kreshtat e dy maleve në Bashkinë e Lezhës, të cilat do të jenë të afta të gjenerojnë 234 MW dhe do të zhvillohet në një sipërfaqe prej 100 ha, në vargmalet e Rencit dhe Kakariqit, të vendosura paralel | Bashkia Lezhë | Shtet | Vendim i KIS Nr. 11/6, datë 4.2.2021. | Projekti ende nuk ka filluar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |

|    |                                                            |         |                                |        |                                                                                                                                                                                                          |                |                  |                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----|------------------------------------------------------------|---------|--------------------------------|--------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|------------------|---------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                                                            |         |                                |        | me vijën bregdetare në Shëngjin dhe Balldren, Lezhë.                                                                                                                                                     |                |                  |                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 21 | ILIR TREBICKA                                              | Turizëm | € 5,500,000<br>90 vende pune   | 2 vjet | Ndërtim i një hoteli me 4 yje, si pjesë e kompleksit turistik të quajtur "Thymus", i cili shtrihet në një sipërfaqe totale prej 0.33 ha, të ndodhur në zonën kadastrale 1739, në fshatin Dhërmi, Himarë. | Bashkia Himarë | Privat           | Vendim i KIS Nr. 14/6, datë 4.2.2021. | Projekti ende nuk ka filluar.                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 22 | COAST TO COAST SH.P.K.<br><br>GJIKURIA SH.P.K.             | Turizëm | € 56,910,000<br>150 vende pune | 6 vjet | Investimi kompleks i përbërë nga 3 hotele dhe vila rezidenciale me sipërfaqe truall 20.9 ha, në zonën kadastrale 1739, në fshatin Gajtانيتika dhe Perivolo, Himarë.                                      | Bashkia Himarë | Shtet dhe privat | Vendim i KIS Nr. 10/8, datë 4.2.2021. | Projekti nuk ka nisur ende.<br><br>Zona kadastrale 1739, nuk është e menaxhuar dhe për pasojë nuk është bërë regjistrimi nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajjtshme, Vlorë, çka vështirëson punën për evidentimin e pronarëve dhe të problematikave që mund të ketë. |
| 23 | DELTA SH.A.<br><br>"Delta Falaise Resort & Village Faza 1" | Turizëm | € 51,267,942<br>243 vende pune | 4 vjet | Faza 1 parashikon ndërtimin e një Resorti me 5 yje, që do të përbëhet nga 1 ndërtesë 3 katëshe me një lartësi maksimale prej 12                                                                          | Bashkia Himarë | Shtet dhe privat | Vendim i KIS Nr. 15/6, datë 4.2.2021. | Projekti nuk ka nisur ende.                                                                                                                                                                                                                                                                   |

|    |                                                                           |         |                                  |        |                                                                                                                                                                                  |                  |                  |                                       |                                                                                                                                                                                |
|----|---------------------------------------------------------------------------|---------|----------------------------------|--------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|------------------|---------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                                                                           |         |                                  |        | metrash dhe një kapacitet prej 440 dhomash, i cili do të ofrojë shërbime cilësore e me standarde të larta në fushën e turizmit dhe mikpritjes.                                   |                  |                  |                                       |                                                                                                                                                                                |
